Raport

Gjendja e Mbeturinave



MINISTRIA E MJEDISIT
DHE PLANIFIKIMIT
HAPËSINOR

AGJENCIA E KOSOVËS
PËR MBROJTJEN E
MJEDISIT
AKMM

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

AGJENCIA E KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Raport

Gjendja e Mbeturinave në Kosovë

2008

Prishtinë, 2009

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

RAPORT
GJENDJA E MBETURINAVE NË KOSOVË
2008

Botues:
Ministria e Mjedisit dhe Planifkimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

Këshilli Redaktues
MSc. Tafë Veselaj- AKMM
MSc. Afrim Berisha- AKMM
MSc. Mimoza Hyseni- AKMM
Ibrahim Balaj- MMPH
Bajram Kafexholli-AKMM

Kontribues tjerë:
Riza Hajdari-AKMM
Enver Tahiri-MMPH
Sabit Restelica- AKMM
Ajet Mahmuti- AKMM
Tone Gashi-AKMM
Mr.sc. Florije Tahiri- MMPH
Lindita Xhema- MMPH
Mr.sc. Sami Behrami-AKMM
Perparim Gashi- AKMM
Ardiana Pllana- AKMM

Lektor:
Tone Buzhala-Gashi

Dizajni:
Design house

Ballina dhe faqja e fundit:
Ylber Sherifi

U shtyp në shtypshkronjën:
Design house

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Parathënie

Një ndër çështjet më të rëndësishme për menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit në Kosovë, është edhe menaxhimi i mbeturinave. Deri me tani Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka përgatitur bazën e duhur ligjore për menaxhimin e mbeturinave(Ligjin për mbeturina dhe një sërë udhëzimesh administrative që rregullojnë këtë fushë). Po ashtu, në kuadër të obligimeve ligjore dhe programore është duke u përgatitur edhe Plani Strategjik për Administrimin e Mbeturinave. Edhe përkundër faktit se roli i MMPH-së ka qenë i kufizuar vetëm në aspektin legjislativ, ajo ka bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave. Në këtë aspekt, MMPH ka arritur që ta adresojë këtë çështje në mënyrën e duhur duke bashkëpunuar ngushtë me institucione e organizata të ndryshme. Ne jemi të vetëdijshëm se menaxhimi i mbeturinave nuk mund të kryhet vetëm nga një institucion i vetëm, por kërkohet një angazhim i përbashkët, që nga ne institucionet ligjvënëse, ekzekutive, zyra e rregullatorit, komunat, kompanitë menaxhuese të grumbullimit të mbeturinave dhe kompanitë që menaxhojnë deponitë. Është e qartë se rol kyç në këtë aspekt kanë edhe komunat, për faktin se ato janë bartëse të kësaj problematike, por është më se e qartë se rol esencial në këtë drejtim kanë edhe donatorët, shoqëria civile dhe komuniteti i biznesit. Ne duhet ta pranojmë se nuk jemi të kënaqur me sistemin për menaxhimin e mbeturinave. Vështirësitë dhe problemet janë evidente në të gjitha komponentët që nga grumbullimi, selektimi, deponimi, dhe se vështirësitë na shoqërojnë në të gjitha kategoritë e mbeturinave, si të atyre komunale, industriale, të rrezikshme etj, prandaj për organizimin e një sistemi të kënaqshëm të menaxhimit të mbeturinave kërkohet një bashkë koordinim funksional i të gjithë aktorëve të lartpërmendur. Ne duhet që të ndryshojmë qasjen tonë dhe perceptimin e përgjithshëm publik mbi mbeturinat. Mbeturinat duhet të definohen qartë, jo gjithçka që hedhim është mbeturinë, jo gjithçka duhet të groposet në deponi. Duhet të formojmë opinionin i cili tanimë është dëshmuar në shtetet e zhvilluara se mbeturinat nuk janë objekt për hedhje, por janë resurs për zhvillimin ekonomik të vendit, janë një mundësi për të krijuar vende pune, janë një mundësi për të kursyer resurset natyrore. Ne synojmë që në këtë proces, t'i kushtohet rëndësi opsioneve më të pranueshme në kuadër të menaxhimit të mbeturinave si: marrja e masave preventive, minimizimin e gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimin, riciklimin, përdorimin e tyre si resurs energjie etj. Ajo që është kryesore, me një qasje të tillë ne i kontribuojmë ruajtjes së mjedisit, gjë që është edhe qëllimi ynë kryesorë.

Mahir Yagcilar,
Ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Falënderim

Të nderuar lexues dhe bashkëpunëtorë, në duart tuaja keni një Raport, që përmban informata themelore për gjendjen e mbeturinave në Kosovë. Ky raport është përgatitur nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, në kuadër të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive që ka ky institucion në raportimin për gjendjen e sektorëve të mjedisit. Përgatitja e këtij Raporti është ndihmuar dhe mbështetur edhe nga sektorët e tjerë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e veçanërisht nga Divizioni për Administrimin e Mbeturinave i Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit. Në mbledhjen e të dhënave të nevojshme për përgatitjen e Raportit, kontribut të çmuar kanë dhënë edhe Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës-KMDK, Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina-ZRRUM, Kompanitë regjionale të mbeturinave dhe institucionet tjera. Ne, vlerësojmë se ngritja e shkallës së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për administrimin e mbeturinave, do të përmirësoj dukshëm edhe procesin e mbledhjes, shkëmbimit dhe përpunimit të të dhënave si dhe raportimin për gjendjen e këtij sektori mjedisor. Me këtë rast AKMM, shpreh falënderime për të gjitha institucionet qeveritare dhe joqeveritare, operatorët ekonomik, donatorët, ekspertët dhe ndërmarrjet e ndryshme për bashkëpunimin e treguar në finalizimin e këtij Raporti. Në veçanti falënderojmë GTZ-n, për mbështetjen financiare në botimin e këtij Raporti dhe për përkrahjen e vazhdueshme të aktiviteteve të AKMM-së.

Dr. Ilir Morina
Kryeshef Ekzekutiv i AKMM-së

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Indeksi i shkurtesave

AER	Agjencioni Evropian për Rindërtim
AKMM	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
BE	Bashkimi Evropian
DANIDA	Agjencioni Ndërkombëtar Danez për Zhvillim
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
GTZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
KFOR	Forcat Paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ni-Cd	Nikel Kadmium
NP	Ndërmarrje Publike
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PBB	Poli Bifenil Bromur
PCB	Poli Klorur Bifenil
PCT	Poli Klorur Trefenil
PET	Polietilentereftalat
PIM	Parku Industrial i Mitrovicës
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PSKAM	Plani Strategjik i Kosovës për Administrimin e Mbeturinave
QKMF	Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare
TC	Termocentral
TCA	Termocentrali A
TCB	Termocentrali B
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UA	Udhëzim Administrativ
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZRRUM	Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Indeksi i tabelave

Tabela 1: Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë 1948-2006
Tabela 2: Struktura e popullsisë sipas moshës në Kosovë 1981-2006
Tabela 3. Popullsia e Kosovës sipas regjioneve dhe komunave
Tabela 4: Objektivat, masat dhe aktivitetet e parapara në PKVM
Tabela 5. Lista e projekteve prioritare për mbeturina në PKVM
Tabela 6: Konventat e BE-së për mbeturina dhe niveli i harmonizimit të tyre në legjislacionin kombëtar
Tabela 7: Të dhënat për kompanitë regjionale të mbeturinave
Tabela 8: Historiku i grumbullimit të organizuar të mbeturinave në Kosovë
Tabela 9: Grupet kryesore të mbeturinave sipas katalogut evropian
Tabela 10: Popullata që shërbehet me mbledhjen e mbeturinave sipas komunave
Tabela 11: Sasia ditore dhe vjetore e mbeturinave për banor
Tabela 12: Lloji dhe sasie e mbeturinave të rrezikshme sipas llojit, lokacionit dhe komunave
Tabela 13: Sasia (ton/vit) e mbeturinave medicinale në Kosovë sipas institucioneve shëndetësore dhe lokacioneve
Tabela 14: Sasia e barërave me afat të skaduar në Kosovë
Tabela 15: Sasia e hirit të prodhuar nga termocentralet e KEK-ut sipas viteve
Tabela 16: Përmbajtja në % e hirit sipas komponentëve përbërës
Tabela 17: Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regjionale dhe komunale për vitin 2007 të shprehura në ton
Tabela 18: Sasia e mbeturinave komunale në deponitë sanitare regjionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2008 të shprehura në ton
Tabela 19: Sasia e mbeturinave komunale për banor (kg/vit) sipas regjioneve
Tabela 20: Mesatarja ditore e sasisë së mbeturinave komunale në Kosovë (kg/banorë)
Tabela 21: Deponitë Sanitare në Kosovë, kapaciteti dhe sipërfaqja
Tabela 22: Sipërfaqet dhe sasia e mbeturinave në deponitë e mbeturinave industriale
Tabela 23: Hot- spotet e mbeturinave sipas komunave dhe lokacioneve
Tabela 24. Disa nga kompanitë që bëjnë trajtimin e mbeturinave në Kosovë
Tabela 25: Sasia në ton e mbeturinave të trajtuara në Kosovë sipas llojeve
Tabela 26: Tabela e tarifave (euro/muaj) për grumbullimin e mbeturinave për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak sipas kompanive regjionale
Tabela 27: Tabela e tarifave për grumbullimin e mbeturinave për kategorinë e konsumatorëve komercial/industrial sipas kompanive regjionale
Tabela 28: Tabela e tarifave për grumbullimin e mbeturinave për kategorinë e konsumatorëve institucional
Tabela 29: Niveli i pagesës për grumbullimin e mbeturinave dhe si i konsiderojnë konsumatorët tarifat për këtë shërbim
Tabela 30: Infrastruktura për grumbullimin e mbeturinave sipas kompanive
Tabela 31: Projektet e realizuara për rehabilitimin e deponive të vjetra
Tabela 32: Projektet e planifikuara për rehabilitimin dhe mbylljen e deponive
Tabela 33: Investimet në ndërtimin e deponive sanitare në Kosovë

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Indeksi i figurave

Figura 1: Mbeturinat sipas llojeve në Kosovë (%)

Figura 2: Fraksionet e mbeturinave komunale (%)

Figura 3: Përqindja e grumbullimit të mbeturinave sipas vendit të hedhjes për regjionin e Prishtinës

Figura 4: Përqindja e grumbullimit të mbeturinave për regjionet tjera në Kosovë

Figura 5: Përqindja e grumbullimit të mbeturinave sipas vendit të hedhjes për tërë territorin e Kosovës

Figura 6. Kënaqshmëria e konsumatorëve me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave

Figura 7: Shkalla e shërbimit për grumbullimin e mbeturinave në raport me shërbimet tjera publike

Figura 8: Sasia e mbeturinave komunale në deponitë sanitare për vitin 2008

Figura 9: Sasia e mbeturinave komunale në deponi sipas viteve (2006-2008)

Figura 10: Sasia e mbeturinave komunale për banor (kg/vit) sipas regjioneve

Figura 11: Mesatarja vjetore e gjenerimit të mbeturinave në Kosovë (kg/banor)

Figura 12: Deponitë industriale sipas sipërfaqes (ha)

Figura 13: Hierarkia e administrimit të mbeturinave

Figura 14: Llojet e mbeturinave që trajtohen në Kosovë (ton/muaj)

Indeksi i hartave

Harta 1: Shtrirja e kompanive regjionale të mbeturinave

Harta 2: Shtrirja e insineratorëve për djegien e mbeturinave medicinale

Harta 3: Shtrirja e deponive regjionale

Harta 4: Deponitë e mbeturinave

Harta 5: Lokacionet e hot- spoteve potenciale të mbeturinave dhe hot-spoteve tjera

Harta 6: Disa pika të trajtimit të mbeturinave në Kosovë

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

PËRMBAJTJA

1. HYRJE

1.1. Disa karakteristika të përgjithshme për Kosovën

1.1.1. Pozita gjeografike
1.1.2. Relievi
1.1.3. Klima
1.1.4. Struktura e popullsisë

1.2. Korniza ligjore dhe strategjike për mbeturina

1.2.1. Ligjet dhe udhëzimet administrative për mbeturina
1.2.2. Strategjia e Kosovës për mjedis
1.2.3. Plani strategjik i Kosovës për administrim të mbeturinave
1.2.4. Plani i Kosovës për veprim në mjedis
1.2.5. Direktivat e Bashkimit Evropian për mbeturina

1.3. Struktura Institucionale

1.3.1. MMPH
1.3.2. AKMM
1.3.3. Pushteti lokal
1.3.4. ZRRUM
1.3.5. KMDK
1.3.6. Kompanitë regjionale
1.3.7. Sektori privat

2. MBETURINAT

2.1. Definimet dhe nocionet për mbeturinat
2.2. Historiku i administrimit të mbeturinave
2.3. Klasifikimi dhe llojet e mbeturinave
2.4. Mbeturinat komunale
2.5. Mbeturinat industriale
2.6. Mbeturinat medicinale dhe barërat me afat të skaduar
2.7. Mbeturinat e hirit
2.8. Mbeturinat e ndërtimit
2.9. Llojet tjera të mbeturinave

3. GJENDJA DHE ADMINISTRIMI I MBETURINAVE

3.1. Gjenerimi i mbeturinave në komuna
3.2. Deponitë e mbeturinave

3.2.1. Deponitë e vjetra të mbeturinave komunale
3.2.2. Deponitë sanitare regjionale dhe komunale

3.2.2.1. Deponia regjionale Gjilan
3.2.2.2. Deponia komunale Podujevë
3.2.2.3. Deponia regjionale Prizren
3.2.2.4. Deponia regjionale Prishtinë
3.2.2.5. Deponia regjionale Pejë
3.2.2.6. Deponia regjionale Mitrovicë
3.2.2.7. Deponia komunale Sharr
3.2.2.8. Stacioni transferues Ferizaj
3.2.2.9. Deponia komunale e Fushë Kosovës
3.2.2.10. Deponia komunale e Zveçanit

3.3. Deponitë industriale
3.4. Hot-spotet e mbeturinave

4. TRAJTIMI I MBETURINAVE
4.1. Koncepti i trajtimit të mbeturinave
4.2. Riciklimi i mbeturinave
4.3. Reduktimi në burim
4.4. Ripërdorimi
5. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME
5.1. Tarifa për administrimin e mbeturinave
5.2. Infrastruktura për grumbullimin e mbeturinave
5.3. Projektet dhe investimet në sektorin e mbeturinave
6. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET
7. REFERENCAT

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

1. HYRJE

Raportimi për gjendjen e mjedisit në Kosovë është përgjegjësi dhe detyrë e AKMM-së[1], e përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit .

Në kuadër të procesit të raportimit përveç hartimit të Raportit për gjendjen e përgjithshme të mjedisit, AKMM ka për obligim edhe hartimin e raporteve për sektorë të caktuar të mjedisit.

Në kuadër të raportimi për gjendjen e sektorëve mjedisor është edhe Raporti për gjendjen e mbeturinave. Ky Raport përmban të dhëna që janë grumbulluar gjatë punës në terren nga ekipet e AKMM-së, të dhëna që janë siguruar nga kompanitë publike regjionale, KMDK, ZRRUM si dhe institucione tjera qeveritare dhe jo qeveritare. Pjesë e Raportit janë edhe të dhënat e marra nga Ligjet dhe UA për mbeturinat, dokumentet strategjike për mbeturinat si dhe të dhëna nga projektet dhe donatorët në këtë fushë. Disa të dhëna të prezantuara në këtë Raport janë marrë edhe nga publikimet dhe raportet e ndryshme relevante.

Të dhënat e Raportit i referohen kryesisht periudhës 2007-2008, mirëpo në disa raste në mungesë të të dhënave si dhe me qëllim krahasimi janë prezantuara të dhëna edhe të një periudhe të mëhershme.

Raporti është i ndarë në kapituj dhe secili nga kapitujt trajton një aspekt të caktuar. Në pjesën e parë (pjesa hyrëse), përveç disa të dhënave të përgjithshme për Kosovën, është prezantuar edhe gjendja e kornizës ligjore dhe institucionale për administrimin e mbeturinave. Në kapitullin e dytë të këtij Raporti prezantohen të dhëna të përgjithshme për mbeturinat si definimet dhe nocionet për mbeturina, historiku i administrimit të mbeturinave dhe klasifikimi i mbeturinave.

Në kapitullin e tretë përshkruhet gjendja e mbeturinave duke përfshirë gjenerimin e mbeturinave komunale dhe gjendjen e deponive.

Një kapitull tjetër i Raportit është edhe trajtimi i mbeturinave ku përshkruhen format dhe mënyrat e trajtimit dhe aplikimin e tyre në Kosovë.

Raporti përmban edhe kapitullin për aspektet e përgjithshme të administrimit të mbeturinave, ku trajtohen tarifat, infrastruktura, projektet dhe investimet në lëmin e mbeturinave. Në një kapitull të veçantë Raporti nxjerr konkluzionet dhe jep rekomandime për tejkalimin e gjendjes.

Dy kapitujt e fundit përfshijnë Referenca/burimet e të dhënave të prezantuara si dhe shtojcat e Raportit.

1.1. DISA KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME PËR KOSOVËN

1.1.1. Pozita gjeografike

Kosova ka pozitë qendrore gjeografike në Gadishullin Ballkanik. Shtrihet në mes të 41°50’58” dhe 43°51’42” të gjerësisë gjeografike veriore dhe 20°01’30” dhe 21°48’02” të gjatësisë gjeografike lindore. Kosova ka sipërfaqe 10.887 km², me rreth 2.1 milion banorë (vlerësim i vitit 1991) dhe me dendësi mesatare prej 192 banor në km². Kufizohet me Shqipërinë (në jugperëndim), me Maqedoninë

1 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Ligji Nr.03/L-025)r

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

(në juglindje), me Serbinë (në lindje, veri dhe verilindje) dhe me Malin e Zi (në perëndim). Gjatësia e përgjithshme e kufirit të Kosovës me vendet fqinje është rreth 700.7 km.

1.1.2. Relievi

Kosova është vend malor dhe me ultësira, i përbërë nga Fusha e Kosovës (me lartësi mbidetare 510-570 m) dhe Rrafshi i Dukagjinit (lartësia mbidetare 350-450 m). Nga aspekti **morfologjik** paraqet një mozaik të vërtetë të fushëgropave me dimensione të ndryshme, të përkufizuar me male të mesme e të larta. Lartësia mesatare mbidetare e Kosovës është (810m), kurse pika me e ulët është (270m) e ajo me e larta (2656m) (Gjeravica). Në aspektin hipsometrik sipërfaqe nën 300m lartësi mbidetare përfshinë vetëm 16.4 km² (0.2 %) deri 1000 m shtrihen 8754 km² (80.7 %), prej 1000 deri 2000 m 1872.3 km² (17 %) dhe mbi 2000m deri 250.6 km² (2.3 %). Format kryesore në relievin e Kosovës janë: Malet me (63 %) dhe fushëgropat (37%).

1.1.3. Klima

Klima është e mesme-kontinentale, me ndikim mbizotërues të klimës adriatiko - mesdhetare në Rrafshin e Dukagjinit, përmes luginës së Drinit të Bardhë, si dhe me ndikim më të vogël të klimës së ndryshuar adriatiko-egjeniane në fushën e Kosovës. Të reshurat mesatare vjetore **596 mm**. Temperaturat mesatare vjetore të Kosovës janë **10 ^{O}C**, me temperaturën e arritur minimale **-27,2** dhe maksimale **39,2** (IHMK, 2008). Makrofaktorët kryesorë klimatikë, të cilët ndikojnë në klimën e Kosovës janë: pozita e saj ndaj masave tokësore (Euroazia dhe Afrika), masat ujore (Oqeani Atlantik dhe Deti Mesdhe), masat e ajrit (tropike dhe arktike-maritine apo kontinentale), pozita e sistemeve barike (maksimumi i azoreve dhe minimumi i Islandës). Faktorët lokal kryesorë që ndikojnë në klimën e Kosovës janë: relievi, ujërat, trualli dhe bimësia.

1.1.4. Struktura e Popullsisë

Kosova për një periudhë të gjatë kohore (mbi 25 vjeçare) ballafaqohet me mungesë të dhënave statistikore për popullsinë, kështu që përcaktimi i numrit të popullsisë bëhet kryesisht në bazë të vlerësimeve dhe parashikimeve.

Numri i përgjithshëm i popullsisë së Kosovës edhe për kundër shpërnguljeve dhe trysnive të shumta ndaj saj vazhdimisht është rritur në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore me ritme të ndryshme. Gjatë periudhës 58 vjeçare (1948-2006) popullsia e Kosovës kishte një rritje prej 188.5%.

Tabela 1: Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë 1948-2006

Viti	Numri i Banorëve	Komentet
1948	727820	Regjistrimi
1961	963988	Regjistrimi
1971	1243693	Regjistrimi

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

1981	1584440	Regjistrimi
1991	1956196	Vlerësimi
2002	1985000	Vlerësimi i ESK
2006	2100000	Vlerësimi i ESK

Popullsia e Kosovës është me moshë të re. Në vitin 2006 grup-mosha 0-19 vjet përbën 38 %, grup-mosha e 20-64 përbën 56 % kurse grup-mosha e vjetër mbi 65 vjet përbën 6 % të popullsisë së përgjithshme.

Tabela 2: Struktura e popullsisë sipas moshës në Kosovë 1981-20062&3

	1981	1991	2001	2006
0-19 vjet	52	48	41	38
20-64 vjet	43	47	54.1	56
Mbi 65 vjet	5	5	5.9	6

Ndërsa sipas të dhënave nga OSBE në Kosovë ka rreth 2.363.000 banorë.

Tabela 3. Popullsia e Kosovës sipas regjioneve dhe komunave[4]

Regjioni/Komuna	Gjithsej
Regjioni i Prishtinës	**892,506**
1. Drenasi	55,000
2. Fushë Kosova	40,416
3. Lypjani	74,643
4. Kastrioti	30,000
5. Besiana	117,040
6. Prishtina	545,477
7. Shtimja	29,930
Regjioni i Pejës	**383,494**
8. Deçani	41,499
9. Gjakova	127,007
10. Burimi	43,985
11. Klina	46,003
12. Peja	125,000
Regjioni i Mitrovicës	**316,957**
13. Mitrovica	113,145
14. Albaniku	16,850
15. Skenderaj	65,312
16. Vushtrria	90,000
17. Zubin Potoku	14,800
18. Zveçani	16,850
Regjioni i Prizrenit	**423,797**
19. Sharri	34,562
20. Rahoveci	65,896
21. Prizreni	236,039

2 Buletini 17, ESK, 1991-2001, Ecuria dhe shtrirja e pop. Shqiptare në Ish Jugosllavi, Instituti Ekonomik 1997, 2006,

3 Kosova në shifra 2006, ESK, Prishtinë 2007.

4 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian-OSBE, 2004

22. Theranda	87,300
Regjioni i Gjilanit	**366,442**
23. Gjilani	90,870
24. Kaçaniku	43,004
25. Dardana	64,000
26. Artana	13,633
27. Shtërpca	11,187
28. Ferizaj	96,993
29. Vitia	46,815
NUMRI I PËRGJITHSHËM	**2,363,885**

1.2. KORNIZA LIGJORE DHE STRATEGJIKE PËR MBETURINA

1.2.1. Ligjet dhe Udhëzimet Administrative për Mbeturina

Fusha e administrimit të mbeturinave në Kosovë rregullohet përmes Ligjit për mbeturina, Nr 02/L-30.

Qëllimi i këtij Ligji është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit nga ndotja dhe rreziku nga mbeturinat, përmes administrimit të mirëfilltë (të qëndrueshëm) të mbeturinave, duke krijuar kushte për parandalimin dhe zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave dhe rrezikshmërisë së tyre, veçanërisht përmes:

- Zhvillimit të teknologjive të pastra dhe përdorimit efikas të tyre;
- Zhvillimit dhe përdorimit të produkteve të cilat për nga natyra e prodhimtarisë dhe deponimit përfundimtar të tyre, janë të dizajnuara për uljen e dëmshmërisë së mbeturinave dhe rrezikshmërisë nga ndotja;
- Zhvillimit të teknikave të duhura për magazinimin e substancave të rrezikshme të cilat i përmbajnë mbeturinat me mundësi përpunimi;
- Përpunimit të mbeturinave me anë të riciklimit, ripërdorimit apo të ndonjë procesi tjetër, për nxjerrjen e lëndëve sekondare;
- Djegien e mbeturinave si burim i energjisë dhe
- Sanimit të vendeve të ndotura nga mbeturinat.

Për plotësimin e ligjit për mbeturina janë miratuar udhëzimet administrative:

- Udhëzimi administrativ për administrimin e vajrave të përdorura mbeturinë;
- Udhëzimi administrativ për mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi;
- Udhëzimi administrativ për mbeturina nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar**;**
- Udhëzimi administrativ për administrimin e automjeteve të hedhura dhe mbeturinat e tyre;
- Udhëzimi administrative, ambalazhin dhe ambalazhet mbeturinë;
- Udhëzimi administrativ kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave;
- Udhëzimi administrativ për administrimin e deponive të mbeturinave;

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

- Udhëzimi administrativ për administrimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Udhëzimi administrativ mbi kushtet për zgjedhjen e lokacionit dhe ndërtimin e deponive;
- Udhëzimi administrativ për administrimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike;
- Udhëzimi administrativ për asgjësimin e mbeturinave nga produktet medicinale;
- Udhëzimi administrativ për administrimin e mbeturinave medicinale;
- Udhëzimi administrativ për import, eksport dhe transit të mbeturinave;
- Udhëzimi administrativ për administrimin e PCB-ve dhe PCT-ve.
- Udhëzimi administrativ - Ndëshkimet mandatore;
- Udhëzimi administrativ - Largimi i mbeturinave nga sipërfaqet publike.

Udhëzimet administrative në procedurë të draftimit janë:

- Udhëzimi administrativ - Gomat e vjetra dhe të shpenzuara;
- Udhëzimi administrativ - Licenca për administrimin e mbeturinave;
- Udhëzimi administrativ - Për administrimin e mbeturinave që përmbajnë azbest.

1.2.1. Strategjia e Kosovës për Mjedis

Strategjia për mjedisin përbën një komponentë të rëndësishme afatgjate të zhvillimit të përgjithshëm të Kosovës. Hartimi i Strategjisë është realizuar përmes bashkëpunimit ndërministror dhe me ndihmën e institucioneve tjera. Strategjia ka këto orientime strategjike në fushën e administrimit të mbeturinave[5]:

- Krijimin e infrastrukturës ligjore apo teknike për menaxhim të mbeturinave;
- Zvogëlimin gradual të sasisë së mbeturinave në burim, dhe shfrytëzimit energjetik apo ripërdorimit;
- Zvogëlimin gradual të rrezikut nga mbeturinat;
- Zvogëlimin e deponimit të mbeturinave organike;
- Riciklimin e mbeturinave;
- Rritjen graduale të përfshirjes së popullatës në sistemin e grumbullimit të mbeturinave.

Ndërsa prioritetet e strategjisë në aspektin e administrimit të mbeturinave janë:

- Kompletimi i normave ligjore për menaxhimin e mbeturinave mbështetur në direktivat e BE;
- Ndërtimi i infrastrukturës ligjore apo teknike për menaxhim të mbeturinave;
- Ndërtimi i sistemit qendror të të dhënave dhe të informimit mbi gjendjen e

5 Strategjia e Kosovës për Mjedis, MMPH 2003

menaxhimit të mbeturinave;
- Hartimi i programeve për ndërtimin e objekteve, në harmoni me planet hapësinore;
- Sanimi dhe mbyllja e deponive të vjetra;
- Shfrytëzimi i objekteve industriale ekzistuese, për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme.

1.2.1. Plani Strategjik i Kosovës për Administrim të Mbeturinave

Sipas Ligjit të Mbeturinave Planin Strategjik për Administrimin e Mbeturinave e harton Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore në bashkëpunim me ministritë dhe autoritetet tjera kompetente. Planin Strategjik e miraton Qeveria e Kosovës për periudhë kohore dhjetë vjeçare. Ky plan duhet të rishqyrtohet së paku çdo pesë vjet.

Planin Strategjik për Administrimin e Mbeturinave duhet të përmbajë:

- Vlerësimin e gjendjes ekzistuese të administrimit të mbeturinave;
- Qëllimet themelore dhe masat për administrimin e mbeturinave;
- Masat për administrimin me mbeturina të rrezikshme;
- Orientimet për përpunimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe parimet administrative;
- Orientimet për deponimin e mbeturinave;
- Orientimet për sigurimin e masave më të volitshme teknike, prodhuese dhe administruese për arritjen e qëllimeve për administrimin e mbeturinave.

1.2.1. Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2010

Në kuadër të Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2010, në kapitullin për menaxhimin e mbeturinave janë përcaktuar objektivat, masat, aktivitetet dhe projektet prioritare për periudhën 2006-2010.

Tabela: 4: Objektivat, masat dhe aktivitetet e parapara në PKVM[6]

Objektivat	**Të zhvillohet një sistem i qëndrueshëm financiar për menaxhimin e mbeturinave i cili do të shërbejë nevojave të tanishme dhe të ardhshme të qytetarëve dhe të ekonomisë së vendit**
Masat	• Miratimi i dokumenteve politike për menaxhimin e mbeturinave; • Miratimi i nën-ligjeve të nevojshme dhe harmonizimi i plotë i tyre me legjislacionin e BE; • Formimi i instrumenteve të shëndosha ekonomike; • Forcimi institucional për menaxhimin e mbeturinave në nivel qendror dhe lokal.

6 Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2010, MMPH 2005

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Aktivitetet	Hartimi i Planit Strategjik për menaxhimin e mbeturinave
	Hartimi i planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave
	Aprovimi i 18 rregulloreve për lloje të ndryshme të mbeturinave dhe zbatimi i legjislacionit ekzistues
	Avancimi i sistemit për grumbullimin e mbeturinave komunale
	Pilot projekte si: • mbledhja e mbeturinave-vajrave ; • ndarja e mbeturinave të llojeve të veçanta (letër/karton, plastikë/PET -kompostim (mbeturinat komunale); • rikuperimi
	Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës të nevojshme për menaxhimin e mbeturinave
	Ndërtimi i infrastrukturës për menaxhim të mbeturinave të rrezikshme: • Vendgrumbullimet; • Qendrat grumbulluese.
	Sanimi i gjendjes në 'pikat e nxehta' ekzistuese
	Ngritja e kapaciteteve njerëzore në menaxhimin e mbeturinave posaçërisht inspeksionit
	Zhvillimi i Sistemit të Informimit për menaxhim të mbeturinave
	Rehabilitimi i deponive të vjetra

Tabela 5. Lista e projekteve prioritare për mbeturina në PKVM[7]

Nr:	**Projekti**	**Buxheti (EUR)**
1.	Rehabilitmi i deponisë së hirit në termocentralin Kosova A	3.700.000
2.	Ndërtimi i një objekti të përkohshëm për ruajtjen e mbeturinave të rrezikshme	760,000
3.	Pilot projekt mbi rehabilitimin e deponive të vjetra në komuna	133,950
4.	Zgjerimi i infrastrukturës për mbledhjen e mbeturinave shtëpiake nëpër fshatra	139,305
5.	Përdorimi i serishëm i mbeturinave organike – mbështetja për iniciativat lokale për prodhimin (përpunimin) e plehrave dhe themelimin e fabrikës për përpunimin e plehrave	1,254,910
6.	Objekti qendror për sterilizimin e mbeturinave infektive	I pa definuar
TOTAL		**5,988,165**

1.2.1. Direktivat e Bashkimit Evropian për Mbeturina

Në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, administrimi i mbeturinave është i rregulluar përmes disa direktivave. Në tabelën 6 ka të dhëna për qëllimin e disa prej këtyre direktivave, vitin e ratifikimit dhe harmonizimin e tyre me legjislacionin kombëtarë. Raporti i monitorimit të progresit, i hartuar nga Zyra regjionale për Mjedis-Rec, në vitin 2008, vlerëson se Kosova ka shënuar progres shumë të mirë në transpozimin e legjislacionit kombëtarë me direktivat e Bashkimit Evropian për menaxhimin e mbeturinave[8].

7 Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2011, MMPH 2005
8 Raporti i monitorimit të progresit, REC 2008

Tabela 6: Direktivat e BE-së për mbeturina dhe niveli i harmonizimit të tyre në legjislacion kombëtarë.

Nr.	Emri i direktivës	Viti i ratifikimit	Qëllimi i direktivës	Harmonizimi me legjislacionin kombëtarë (%)[1]
1	Direktiva për mbeturinat (2006/12/EC)	05 Prill 2006	Mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga rreziqet që shkaktohen nga mbledhja, transporti, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave	95 %
2	Direktiva për mbeturina të rrezikshme (91/689/EC)	12 dhjetor 1991	Unifikimi i ligjeve të shteteve anëtare të BE për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme	85 %
3	Direktiva për ambalazhet mbeturinë (94/62/EC)	15 dhjetor 1994	Minimizimi i ambalazheve mbeturinë si dhe promovimi i ri- përdorimit dhe riciklimit të tyre	88 %
4	Direktiva për deponitë (99/31/EC)	16 korrik 1999	Parandalimi ose zvogëlimi sa ma shumë qe është e mundur i efekteve negative të deponisë në mjedis.	77 %
5	Direktiva për incinerimin e mbeturinave (2000/76/EC)	28 dhjetor 2000	Të parandaloj ose limitoj sa ma shumë qe është e mundur efektet negative në mjedis, në veçanti ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës nga emisionet që lirohen me incinerimin e mbeturinave	69 %
6	Direktiva për mbikëqyrje dhe kontroll të transportit të mbeturinave brenda dhe jashtë Evropës (259/93/EC)	1 shkurt 1993	I zhvendos masat e Konventës se Bazelit për kontrollin e lëvizjes ndërkufitarë te mbeturinave te rrezikshme dhe hedhjen e tyre.	Nuk ka vlerësim
7	Direktiva për hedhjen e poliklorureve të bifenileve (PCB) dhe poliklorureve të trifenileve (PCT) (96/59/EC)	16 shtator 1996	Kjo direktive obligon shtetet anëtare që të bëjnë invertartizimin e mjeteve qe përmbajnë PCB dhe përzierjeve që përmbajnë më shumë se 0.005%PCB në një masë prej 5 litrave.	Nuk ka vlerësim

1.3. STRUKTURA INSTITUCIONALE

1.3.1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Qeveria e Kosovës përbëhet nga 13 ministri, ndër të cilat është MMPH-ja. MMPH krijon politika, zbaton ligjet dhe mbikëqyrë aktivitetet për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duke përfshirë ujin, ajrin, tokën, biodiversitetin etj.

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Në fushën e administrimit të mbeturinave sipas ligjit për mbeturinat Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kryen këto aktivitete:

- Harton planin strategjik për mbeturina ;
- Lëshon licencat për administrimin e mbeturinave dhe mban evidencën në regjistra;
- Aprovon planet lokale për administrimin e mbeturinave;
- Zbaton marrëveshjet ndërkombëtare për administrimin e mbeturinave;
- Aprovon sistemimin për mbulimin e shpenzimeve administrative, lidhur me administrimin e mbeturinave[9].

1.3.1. Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit-AKMM

AKMM si institucion ekzekutiv mjedisor kryen këto detyra dhe përgjegjësi në administrimin e mbeturinave:

- Monitoron gjendjen e deponive regjionale dhe lokale;
- Mbledh dhe përpunon të dhënat për deponitë regjionale dhe lokale;
- Mbledh dhe përpunon të dhënat për mbeturinat e rrezikshme, te parrezikshme, mbeturinave inerte etj;
- Krijon bazën e shënimeve dhe sistemin informativ për administrimin e mbeturinave;
- Përgatit dhe harton raporte për gjendjen dhe administrimin e mbeturinave dhe raporton për gjendjen, parashikimet dhe zhvillimet për efektet qe ndërlidhen me mbeturinat.
- Parashikon dhe paralajmëron rrezikut nga deponitë e mbeturinave për popullatën, dhe për mundësin e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore.

1.3.1. Pushteti Lokal- Komunat

Sipas Ligjit për mbeturinat, komunat si institucione lokale në administrimin e mbeturinave kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

- Të hartojnë planin lokal për administrimin e mbeturinave;
- Të hartojnë raporte vjetore mbi administrimin e mbeturinave të cilat i dorëzojnë në Ministri, në tremujorin e parë të vitit vijues;
- Të rregullojnë, zbatojnë dhe organizojnë administrimin e mbeturinave komunale në territorin e tyre;
- Të marrin pjesë në lëshimin e vendimeve për ndërtimin e objekteve, për trajtimin e mbeturinave;
- Të kryejnë punë tjera, të përshkruara me këtë ligj si dhe aktet tjera, për administrim të mbeturinave;
- Të caktojnë tarifat për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave[10].

9 Ligji per mbeturinat /Ligji nr.02L-30
10 Ligji për mbeturinat /Ligji nr.02L-30

1.3.1. Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina -ZRRUM

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) është rregullator i pavarur ekonomik për shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë.

Roli i ZRRUM është që të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore, efiçente dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për tërë konsumatorët në Kosovë, duke marrë parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.

Detyrat dhe përgjegjësitë e ZRRUM, në sektorin e mbeturinave janë:

- Licencimi i ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbimet e grumbullimit, transportimit dhe deponimit të mbeturinave.
- Përcaktimi i tarifave të shërbimit për ofruesit e shërbimeve të licencuar nga ZRRUM, duke u përkujdesur që tarifat të jenë të drejta dhe të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve;
- Mbikëqyrja e zbatimit të standardeve të shërbimit që ofrojnë ofruesit e licencuar të shërbimeve;
- Aprovimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të Kartës së Konsumatorëve që rregullon të drejtat dhe obligimet e ndërsjella ndërmjet konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të licencuar nga ZRRUM;
- Themelimi dhe mbështetja e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në shtatë regjionet e Kosovës[11].

1.3.1. Kompania për menaxhimin e Deponive të Kosovës- KDMK

KDMK është ndërmarrje publike qendrore për menaxhimin e deponive[12]. Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (ish KLMC), është operatore legale e licencuar për Menaxhimin e Deponive Sanitare të Mbeturinave në Republikën e Kosovës. Aktualisht nën menaxhimin e KDMK-së janë: Deponia sanitare e Gjilanit, e Prizrenit, e Ferizajt, e Prishtinës dhe e Podujevës. KMDK është e regjistruar si kompani aksionare me emrin Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë – Sh.A. – Prishtinë.

1.3.2. Kompanitë regjionale

Procesin e grumbullimit, bartjes dhe deponimit të mbeturinave nga vendbanimet deri te deponitë, e kryejnë 7 kompani regjionale. Sipas ligjit për ndërmarrjet publike, këto kompani janë ndërmarrje publike lokale[13]

Të dhënat për kompanitë regjionale ose siç quhen ndryshe serviset regjionale të mbeturinave janë prezantuar në tabelën 7.

11 Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina 2009
12 Ligji për ndërmarrjet publike/Ligji 03/L-087
13 Ligji për ndërmarrjet publike/Ligji 03/L-087

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Tabela 7: Të dhënat për kompanitë regjionale të mbeturinave[14]

Nr	Kompania	Regjioni	Adresa	Kontakti: tel/fax/e-mail
1	Pastrimi	Prishtinë	Rr.Bill Klinton p.n, 10000, Prishtinë	Tel: (038) 525 191 Fax: (038) 525 191 krm_pastrimi@yahoo.com
2	Ekoregjioni	Prizren	Rr.Tahir Sinani Nr.59 20000, Prizren	Tel: (029) 244 260 Fax: (029) 244 753 krm_ecoregjioni@yahoo.com
3	Ambienti	Peje	Rr.Fatmir Uka Nr.24 30000, Pejë	Tel: (039) 434 729 krm_ambienti@yahoo.com
4	Uniteti	Mitrovicë	Rr.Vëllezërit Dragaj p.n. 40000, Mitrovicë	Tel: (028) 533 983 ext. 109 Fax: (028) 533 211 krm_uniteti@yahoo.com
5	Çabrati	Gjakove	Rr.Mazllom Lakuci p.n 50000 Gjakovë	Tel: (0390) 324 884 Fax: (0390) 321 588 krm_cabrati@yahoo.com
6	Higjiena	Gjilan	Rr. Adem Jashari nr.111, 60000, Gjilan	Tel: (0280) 320 040 & 323 040 Fax: (0280) 324 040 krm_higjiena@yahoo.com
7	Pastërtia	Ferizaj	Rr.Enver Topall nr.44 70000, Ferizaj	Tel: (0290) 327 501 Fax: (0290) 327 501 krm_pastertia@yahoo.com

1.3.3. Sektori Privat

Në ligjin për mbeturinat janë të përcaktuara edhe detyrimet dhe obligimet e të gjithë personave që merren me administrimin e mbeturinave qofshin ato nga sektori privat apo publik. Në Kosovë ekzistojnë një numër i madh i ndërmarrjeve që merren me procesin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit dhe transportimit të mbeturinave.

14 Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës, KMDK



Harta 1: Shtrirja e kompanive regjionale të mbeturinave

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

2. MBETURINAT

2.1. Definimet dhe nocionet për mbeturinat

Mbeturinë - çdo substancë ose lëndë e specifikuar të cilën zotëruesi e hedhë, mendon ta hedhë ose është i detyruar ta hedhë.

Hedhurinë - pjesë e mbeturinës, lëndë ose substancë e cila mbetet pas përpunimit të mbeturinës, komponentë ose elemente të cilat nuk kanë më vlerë përdorimi.

Administrimi i mbeturinave – nënkupton grumbullimin, mbledhjen, ndërmjetësimin, marrjen me to, transportimin, përpunimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e operacioneve të tilla si dhe përkujdesjen pas mbylljes së deponive.

Riciklimi - proces për trajtimin dhe ripërdorimin e plotë ose të pjesshëm të mbeturinave.

Trajtimi i mbeturinave – përfshinë proceset fizike, kimike, biologjike, termale, ndarjen e mbeturinave në lloje, me qëllim të pakësimit të vëllimit dhe karakteristikave të dëmshme të mbeturinave si dhe lehtësimin për manipulim me mbeturina ose riciklimin e tyre.

Grumbullimi i mbeturinave – është aktivitet sistematik i mbledhjes së mbeturinave, me qëllim të trajtimit të më vonshëm ose deponimit.

Mbeturinat e rrezikshme - janë mbeturinat që kanë së paku njërën nga këto karakteristika si më poshtë: eksplozive, oksiduese, të ndezshme, toksike, kanceroze, korrozive, irituese, dëmtuese, infektuese, teratogjenike, mutagjenike, liron gazra toksike në kontakt me ujin, ajrin ose një acid. Ka mundësi për prodhimin e substancave tjera të rrezikshme dhe ekotoksike

Mbeturina të parrezikshme.- janë mbeturinat që nuk posedojnë karakteristikat e mbeturinave të rrezikshme.

Mbeturina inerte.- janë mbeturina, të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar. Mbeturinat inerte nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk biodegradojnë ose në kontakt me materiet tjera, nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Terë përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Mbeturina komunale – janë mbeturinat nga amvisëritë, po ashtu edhe mbeturinat nga aktivitetet tjera, të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

Mbeturina komerciale – mbeturina të cilat vijnë nga objektet që përdoren vetëm apo kryesisht për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshijnë mbeturinat komunale dhe industriale.

Mbeturinat industriale – janë mbeturina të cilat prodhohen nga aktivitetet ose proceset industriale ose të prodhimtarisë artizanale dhe aktivitet tjera prodhuese.

Kompostimi - është proces i kontrolluar biologjik për zbërthimin e mbeturinave organike nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit që bëhet me qëllim të prodhimit të kompostit.

Asgjësimi i mbeturinave – përfshin proceset pas të cilave nuk parashikohet përpunim tjetër i mbeturinave dhe që mbyllen me groposje apo depozitim.

Mbeturina ushqimore - mbeturinat nga konsumimi i mishit të bagëtive, frutave, perimeve, mbeturinat nga përpunimi, përgatitja , gatimi dhe ngrënia e ushqimeve, janë cilësuar si mbeturina ushqimore.

Mbeturinat e papërpunuara – në këtë grup bëjnë pjesë mbeturinat e djegshme e të padjegshme që mbeten nga veprimtaria e institucioneve, aktiviteteve komerciale etj. Mbeturinat e djegshme përbëhen kryesisht nga: letrat, kutitë e kartuçit, plastikës, tekstilet, druri etj. Ndërsa mbeturinat e padjegshme konsistojnë kryesisht në materiale si: qelqi, alumini, hekuri si dhe materialet tjera jo prej hekuri.

Mbeturinat e ndërtimit dhe shkatërrimit- janë të gjitha mbeturinat prej ndërtimit, rimodelimit dhe riparimit të banesave individuale, objekteve tregtare dhe strukturave të tjera, janë klasifikuar si mbeturina të ndërtimit, ndërsa mbeturinat prej shkatërrimit të ndërtesave dhe të strukturave të tjera, janë klasifikuar si mbeturina të shkatërrimit. Materialet kryesore që bëjnë pjesë në këtë grup janë: gurët, betoni, tullat, hekuri, pjesët prej plumbi, pjesët elektrike.

Mbeturinat bujqësore – janë mbeturina që prodhohen si pasojë e aktiviteteve të ndryshme bujqësore: si nga trajtimet e ndryshme që i bëhen tokës, nga prodhimi i verës, nga prodhimi dhe përpunimi i produkteve të ndryshme bujqësore dhe blegtorale, janë quajtur në mënyrë kolektive si mbeturina bujqësore.

Mbeturinat infektive - janë mbeturina me rrezikshmëri të llojit të veçantë, që gjatë manipulimit apo në kontakt me to, mund të rrezikohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi. Janë mbeturina të cilat krijohen dhe gjenerohen nga spitalet dhe objektet tjera shëndetësore, por edhe nga ngordhja apo vrasja e qenve si dhe nga thertoret e kafshëve etj.

Mbeturinat speciale – janë mbeturinat radioaktive, kontejnerët e përdorur të gazrave të presuar**,** mbeturinat që përmbajnë përqendrime të mëdha të metaleve të rënda toksike (arsenik, plumb etj)**,** sasi të rëndësishme të produkteve kimike të cilave u ka skaduar afati.

Mbeturinat prerëse dhe shpuese – janë shiringat e përdorur, veglat e ndryshme të operacionit dhe të gjitha mbeturinat e tjera shpuese dhe prerëse.

Mbeturinat kimike dhe farmaceutike-janë mbeturinat nga produktet farmaceutike dhe kimike brenda ambalazheve të tyre**.**

Djegie - trajtim termik i mbeturinave që konsiston në shkatërrimin e tyre nga zjarri. Djegia është proces i ndërlikuar, sepse furrat në të cilat bëhet djegia, duhet të jenë të dedikuara në mbrojtje të mjedisit. Është proces i shtrenjtë, joekonomik, por gjithsesi i nevojshëm.

Mbeturinat e qelqit – janë mbeturina nga ambalazhi (shishe, kavanoza etj.) që mund të riciklohen.

Mbeturinat e plastikës - janë mbeturina të pazbërthyeshme biologjikisht të cilat krijohen nga veprimtari të ndryshme (ambalazhe, enë, etj.)

Mbeturinat e gomës - janë mbeturinat e gomave të vjetra dhe ato që krijohen prej veprimtarive të ndryshme.

Mbeturina organike – janë mbeturinat që janë të afta me u zbërthye në procesin aerob apo anaerob. Si mbeturina organike klasifikohen mbeturinat e ushqimit, bujqësore, të letrës etj.

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

2.2. HISTORIKU I ADMINISTRIMIT TË MBETURINAVE NË KOSOVË

Administrimi modern i mbeturinave në Kosovë, ka filluar relativisht vonë, edhe pse zanafilla e grumbullimit të mbeturinave daton që nga viti 1947. Shërbimet e ofruara për administrimin e mbeturinave në fillim kryesisht janë kryer me mjete primitive siç janë: karrocat me kuaj, ndërsa më vonë, këto shërbime janë avancuar me mjete teknike si me traktorë dhe kamionë. Me kalimin e kohës është përmirësuar edhe kualiteti i shërbimeve dhe administrimi i mbeturinave në përgjithësi. Edhe sot Kosova, përkundër investimeve të donatorëve të huaj ka mungesë në infrastrukturën për menaxhimin e mbeturinave.

Në tabelën vijuese është prezantuar një kronologji e shkurtër e aktiviteteve të para, të organizuara në mënyrë institucionale, në lëmin e administrimit të mbeturinave:

Tabela 8: Historiku i grumbullimit të organizuar të mbeturinave në Kosovë[15]

Komuna	Viti i themelimit	Emri i ndërmarrjes	Nr. i punëtorëve
Prizren	1947	Kooperativa banesore për higjienë publike	19
Gjakovë	1951	Enti për pastrimin e qytetit "Ereniku"	..
Rahovec	1953	"Komunalja"	10
Gjilan	1961	Enti komunal Pastërtia	..
Dragash	1968	Ndërmarrja komunale për ndërtim, ujësjellës dhe higjienë	12
Malishevë	1999	"Komunalja"	11

2.3. KLASIFIKIMI DHE LLOJET E MBETURINAVE

Sipas Ligjit për Mbeturina, llojet e mbeturinave janë[16]:

- Mbeturinat komunale,
- Mbeturinat komerciale,
- Mbeturinat industriale,

Një klasifikim tjetër i mbeturinave është edhe klasifikimi që merr për bazë ekspozimin dhe rrezikshmërinë.

Sipas këtij klasifikimi mbeturinat ndahen në:

- Mbeturinat inerte,
- Mbeturinat e parrezikshme,
- Mbeturinat e rrezikshme,

Ekziston edhe klasifikimi i mbeturinave sipas katalogut evropian të mbeturinave.

15 Gjendja e Mbeturinave në Kosovë, MMPH 2005
16 Ligji për mbeturina- Ligji nr.02/L-30

Katalogu evropian i mbeturinave është një listë, në të cilën janë përfshirë të gjitha mbeturinat e rrezikshme, të pa rrezikshme dhe ato inerte, dhe si i tillë lehtëson klasifikimin e të gjitha mbeturinave.

Klasifikimi i mbeturinave sipas katalogut evropian të mbeturinave, në bazë të origjinës përfshin 20 – grupe kryesore që janë të prezantuara në tabelën 9:

Tabela 9: Grupet kryesore të mbeturinave sipas katalogut evropian

Nr.	Grupet e mbeturinave
01	Mbeturinat që vijnë si rezultat i eksplorimit, mihjes, mveshjes si dhe përpunimeve tjera të mineraleve dhe minierave.
02	Mbeturinat nga agrokultura, hortikultura, gjuetia, peshkimi dhe prodhimet primare nga aquakultura, përgatitja dhe përpunimi i ushqimit.
03	Mbeturinat nga përpunimi i drurit, prodhimi i letrës, kartuçit, pulpës, panelit dhe mobileve.
04	Mbeturinat nga industritë e lëkurës, gëzofëve, tekstilit.
05	Mbeturinat nga rafinimi i naftës, purifikimi i naftës dhe trajtimi pirolitik i thëngjillit.
06	Mbeturinat nga proceset kimike inorganike.
07	Mbeturinat nga proceset kimike organike.
08	Mbeturinat nga prodhimi, formulimi, furnizimi dhe shfrytëzimi (PFFSh) i shtresave lyerëse (ngjyrave, verniqeve dhe emaeleve pa ngjyrë), ngjitësve, puthitësve dhe ngjyrave të shtypshkronjave.
09	Mbeturinat nga industria fotografike.
10	Mbeturinat inorganike nga proceset termale.
11	Mbeturinat inorganike që përmbajnë metal nga përpunimi i metaleve, mveshja e metaleve dhe hidrometalurgjia e metaleve të ngjyrosura.
12	Mbeturinat nga dhënia e formës dhe përpunimi sipërfaqësor i metaleve dhe plastikës.
13	Mbeturinat e vajrave (përpos vajrave ushqimore, 05 dhe12).
14	Mbeturinat nga substancat organike që përdoren si tretës (përpos 07dhe 08).
15	Mbeturinat nga paketimi i absorbuesve, leckave për fshirje, materialeve filtruese dhe veshjeve mbrojtëse,të cilat nuk janë specifikuar ndryshe
16	Mbeturinat të cilat nuk janë të specifikuara ndryshe në listë.
17	Mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi në ndërtimtari (përfshirë edhe ndërtimin e rrugëve).
18	Mbeturinat nga shërbimet shëndetësore të njerëzve apo të kafshëve dhe/ apo hulumtimeve të tilla (me përjashtim të mbeturinave nga kuzhina dhe restorantet, të cilat nuk vijnë si rezultat i shërbimeve shëndetësore.
19	Mbeturinat nga pajisjet për përpunimin e mbeturinave, mbeturinat nga përpunimi i ujit të ndotur jashtë impiantit dhe industria e ujit.
20	Mbeturinat komunale dhe mbeturinat e ngjashme komerciale, industriale dhe ato institucionale përfshirë edhe fraksionet e mbledhura ndaras.

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Klasifikimi i detajuar i mbeturinave sipas katalogut evropian është prezantuar në Shtojcën 1 të Ligjit për Mbeturinat.

Varësisht se çka është marrë për bazë gjatë klasifikimit, qoftë përmbajtja, origjina ose edhe ndonjë karakteristikë tjetër, ekzistojnë edhe klasifikime dhe lista tjera të mbeturinave. Këto klasifikime dhe lista të tjera të mbeturinave janë të prezantuara si shtojca në Ligjit për Mbeturinat.

2.1. MBETURINAT KOMUNALE

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nuk ofron të dhëna të plota për gjenerimin, mbledhjen, trajtimin dhe mënjanimin e mbeturinave. Mesatarisht në Kosovë me shërbimin për grumbullimin e mbeturinave komunale shërbehen 42 % (viti 2007) përkatësisht 39 % (viti 2008) e popullatës. Regjioni i Prishtinës mbulon përqindjen më të lartë të popullatës me këtë shërbim me 64 % (për vitin 2007) përkatësisht 52 % (për vitin 2008), ndërsa regjioni i Mitrovicës më të ulëtin me vetëm 29 % (2007-2008). Në zonat urbane (qytete) shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet për rreth 90 % të popullatës, ndërkohe që zonat rurale mbulohen me ketë shërbim me vetëm rreth 10 % të popullatës. Të dhënat e detajuara për shërbimet e ofruara për grumbullim të mbeturinave sipas kompanive dhe regjioneve janë prezantuar në tabelën 10.

Tabela 10 : Popullata që shërbehet me mbledhjen e mbeturinave sipas kompanive dhe regjioneve për periudhën 2007-2008 shprehur ne %[17]

Nr.	**Kompania**	**Regjioni**	**Viti**	
			2007	**2008**
1	Ambienti	Pejë	44%	29%
2	Çabrati	Gjakovë	51%	53%
3	Ekoregjioni	Prizren	32%	39%
4	Higjiena	Gjilan	44%	26%
5	Pastërtia	Ferizaj	33%	35%
6	Pastrimi	Prishtinë	64%	52%
7	Uniteti	Mitrovicë	29%	29%

Të dhënat për vlerat mesatare ditore dhe vjetore për mbeturinat komunale janë prezantuar në tabelën 11. Kurse figura 1, tregon se mbeturinat komunale marrin pjesë me 18 %, në kuadër të strukturës se përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara në Kosovë.

17 Zyra Rregullatore për ujë dhe mbeturina, 2009.

Tabela 11: Sasia ditore dhe vjetore e mbeturinave për banor[18]

Llojet e mbeturinave	Mesatarja ditore në kg. / banorë	Sasia vjetore Kg./ banorë	Sasia vjetore në tonelata
Mbeturinat e amvisërisë	0.277	101	232541
Mbeturinat komerciale	0.250	91.25	209875
Mbeturinat medicinale	0.0024	0.876	2014.5
Mbeturinat e hirit dhe ngjyrës	0.907	331	761426.5
Mbeturinat e ndërtimit/ shkatërrimit	0.200	73	167900
Mbeturinat tjera (ambalazh)plastikë, gomë, pesticide, elektronikë, dru etj.	0.360	131.4	302220
Total	**2.05**	**729**	**1675977**



Figura 1: Mbeturinat sipas llojeve në Kosovë (%)

18 Raporti i gjendjes se mjedisit, 2008

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit



Figura 2: Fraksionet e mbeturinave komunale (%)

Në figurën 2 janë paraqitur të dhënat për fraksionet e mbeturinave komunale, nga ku mundë të konludohet se sasinë më të madhe të mbeturinave e përbëjnë mbeturinat organike (35.3 %), ndërsa sasinë më të vogël mbeturinat e rrezikshme (1.2 %).

Ndërsa, të dhënat e prezantuara në figurat 3, 4 dhe 5, tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave grumbullohet sipas shërbimit "derë me derë", ndërkohë që sipas shërbimit për banesa kolektive ky grumbullim është më i vogël. Ky dallim në mes të sasisë së mbeturinave të grumbulluara sipas shërbimit "derë me derë" dhe atij për banesa kolektive është me i shprehur në regjionet tjera të Kosovës, krahasuar me regjionin e Prishtinës.



Figura 3 dhe 4: Përqindja e grumbullimit të mbeturinave sipas vendit të hedhjes për Regjionin e Prishtinës dhe Regjionet tjera në Kosovë[19]

19 Anketa e mbeturinave komunale, Enti i Statistikave te Kosovës 2007



Figura 5: Përqindja e grumbullimit të mbeturinave sipas vendit të hedhjes për tërë territorin e Kosovës20

Nga një hulumtim i realizuar nga ZRRUM rezulton se 61.2% e respondentëve kanë deklaruar se janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave, ndërkaq 14.3% rezultojnë të jenë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me këto shërbime (Figura 6). Ndërsa shkalla e shërbimit për grumbullimin e mbeturinave në raport me shërbimet tjera publike tregon se ky shërbim është në shkallë më të lartë se shërbimet e telefonisë dhe shërbimi i ngrohjes qendrore, kurse është më i ulët se shërbimi i ujësjellësit dhe kanalizimit (Figura 7).



Figura 6. Kënaqshmëria e konsumatorëve me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave21

20 Po aty.

21 Hulumtimi për qëndrimet e konsumatorëve rreth shërbimeve publike për ujë dhe mbeturina në Kosovë- ZRRUM, 2008

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit



Figura 7: Shkalla e shërbimit për grumbullim të mbeturinave në raport me shërbimet tjera publike22

2.2. MBETURINAT INDUSTRIALE TË RREZIKSHME

Shumë substanca në forma të ndryshme agregate kanë mbetur një kohë të gjatë pa u përdorur nëpër stabilimente, depo dhe reparte industriale. Me kalimin e kohës disave nga këto substanca kimike iu ka skaduar afati apo janë degraduar duke ndryshuar përbërjen e tyre dhe konsiderohen si substanca me rrezikshmëri të lartë.

Deri me tani për reduktimin e rrezikut nga substanca të këtilla janë bërë aktivitete në disa ndërmarrje, kryesisht duke u mbështetur nga donacionet dhe aktivitetet e KFOR-it dhe TMK-së .

Si rezultat i prodhimtarisë industriale, ndërprerjes së prodhimit dhe aktiviteteve të tjera hasen edhe shumë materie të rrezikshme. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për llojet e këtyre mbeturinave, lokacionet e deponimit/magazinimit dhe sasinë e tyre deri në vitin 2006.

Tabela 12: Lloji dhe sasia e mbeturinave të rrezikshme sipas lokacionit dhe komunave[23]

LLOJI I MBETURINAVE	SASIA/ NJËSIA	LOKACIONI	KOMUNA
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	49045 m³	Kosova A	Obiliq
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	186 ton	Kosova A	Obiliq
Burime radioaktive	34 njësi	Kosova A	Obiliq
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	25505 m³	Shkritorja Trepça	Mitrovicë
Hipoklorur kalciumi	6.5 ton	Shipol	Mitrovicë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	6300 ton dhe 165 fuqi	Metalurgjia	Mitrovicë
Mbeturinat dhe substancat kimike të lëngëta	600 litra	Metalurgjia	Mitrovicë
Mbeturinat dhe substancat kimike të lëngëta	2000 litra	Industria kimike	Mitrovicë
Mbeturinat dhe substanca kimike të ngurta	10 ton	Tuneli i parë	Mitrovicë

22 Po aty
23 Raport i gjendjes së mjedisit 2008

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Burime radioaktive	3 fuqi	Tuneli i parë	Mitrovicë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	8500 kg	Parku Industrial	Mitrovicë
Mbeturina dhe substanca kimike të lëngëta	42900 litra	Parku Industrial	Mitrovicë
Vajrat PCB	4 trafo	Fabrika e plumbit	Zveçan
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	136 ton	Fabrika e plumbit	Zveçan
Tretësira të ndryshme	2 ton	Metalac Janjevë	Lipjan
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	7.0 m^3	Metalac Janjevë	Lipjan
Mbet. e filmave fotografik	3000 kg	IMK-Fabrika	Ferizaj
Koka të rëntgenit	3 copë	IMK-Fabrika	Ferizaj
Mbeturina me substanca kimike të lëngtë	20 ton	Fabrika e Këmbyesve	Ferizaj
Mbet. e filmave fotografik	2.5 ton	Fabrika e veglave	Ferizaj
Ngjyra tekstili, substanca kimike	9100 kg	Sharr-Tex	Sharr
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	4370 kg	Sharr-Tex	Sharr
Vajra të përdorura	1200 litra	"Adi"	Lipjan
Mbeturinë radioaktive	184 unaza americiumi	Pallati i Rinisë	Prishtinë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	85 ton	Flotacioni-Trepçë	Leposavic
Mbeturina kimike të ngurta	22.2 ton	Fabrika e lëkur-këpucëve	Pejë
Mbeturina dhe substanca kimike të lëngtë	17340 litra	Fabrika e e auto-pjesëve	Pejë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	200 kg	Fabrika e auto-pjesëve	Pejë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	6180 kg	Fabrika e Sharr-Tex	Sharr
Mbeturina dhe substanca kimike të lëngtë	3265 litra	Fabrika e S Sharr-Tex	Sharr
Substanca kimike të ngurta	231.8 kg	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Fuqi plastike me acide	9 fuqi	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Kuti të plastikës të panjohura	9 fuqi	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Substanca shishe pa etiketë	15 copë	Laboratori në Kishnicë	Prishtinë
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	5 ton	Fabrika e tekstilit	Gjakovë

2.3. MBETURINAT MEDICINALE DHE BARËRAT ME AFAT TË SKADUAR

Mbeturinat medicinale janë mbeturina me rrezikshmëri të llojit të veçantë, që gjatë manipulimit apo në kontakt me to, rrezikohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi. Këto mbeturina krijohen në spitale dhe objekte tjera shëndetësore. Edhe ky lloj i mbeturinave nuk trajtohet në mënyrë të duhur. Nga monitorimi në terren dhe të

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

dhënat që i kemi, këto mbeturina nuk grumbullohen, nuk transportohen dhe nuk deponohen sipas normave dhe standardeve të parapara.

Në Kosovë ekzistojnë qendra të cilat posedojnë pajisje (furra) për djegien e mbeturinave spitalore. Konsiderohet se në këto pajisje (furra) bëhet djegia e 20-30% e mbeturinave medicinale, ndërsa pjesa tjetër hedhet në kontejner të mbeturinave komunale. Për djegie të mbeturinave medicinale dhe infektuese në vendin tonë janë katër furra teknikisht më të avancuara të cilat gjenden në: Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Pejë. Këto furra janë të thjeshta me djegie një shkallësh.

Sipas shënimeve të spitaleve dhe shtëpive shëndetësore në tërë vendin brenda ditës krijohen rreth 5500 kg mbeturina spitalore, ndërsa gjatë tërë vitit krijohen 2.014.500 kg apo 2.014.5 ton. Kjo vlerë, kur të llogaritet për kokë banori, në raportin ditor është 0.0023 kg mbeturinë spitalore.

Mbeturinat që krijohen nëpër spitale kanë filluar të grumbullohen në kontejner të dedikuar enkas për këto lloje të mbeturinave, por ekzistojnë raste kur grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave spitalore nuk bëhet si duhet, sidomos në sektorin privat,i cili fare nuk është nën kontroll.

Tabela 13: Sasia (ton/vit) e mbeturinave medicinale në Kosovë sipas institucioneve shëndetësore dhe lokacioneve [24]

Sasia ton/vit	Institucioni shëndetësor	Lokacioni
5 ton/ vit	QKMF	Therandë
5 ton/ vit	QKMF	Gjakovë
14.2 ton/ vit	QKMF	Sharrë
2 ton/ vit	QKMF	Deçan
60 ton/ vit	QKMF	Prishtinë
27 ton/ vit	QKMF	Pejë
5.5 ton/ vit	QKMF	Gjilan
14 ton/ vit	QKMF	Vushtrri
2 ton/ vit	QKMF	Burim
8 ton/ vit	QKMF	Prizren
22 ton/ vit	QKMF	Mitrovicë
24 ton/ vit	QKMF	Viti

24 Raporti i gjendjes së mjedisit 2008



Harta 2: Shtrirja e insineratorëve për djegien e mbeturinave medicinale

Barërat me afat të skaduar- Kosova pas luftës trashëgoi një sasi të konsiderueshme të barërave me afat të skaduar, të cilat ishin akumuluar me vite nëpër barnatore dhe në fabrikën e vetme për prodhimin e barërave. Po ashtu, pas lufte në Kosovë kishte një vërshim të futjes së barërave në cilësinë e ndihmave humanitare, por edhe për qëllime fitimi. Këto barna kanë hyrë pa ndonjë kontroll të cilësisë, sasisë dhe llojit të tyre, njëkohësisht edhe me afat pothuaj të skaduar (për 1-ose 2 muaj).

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Kryesisht barnat gjenden nëpër magazinat e barnatoreve shtetërore dhe në magazinat e doganës, në "Farmakos"-Prizren, në kompaninë "AGANI" dhe magazinën qendrore e cila është në mbikëqyrje të Ministrisë së Shëndetësisë .

Ekzistojnë mbi 100 ton barna me afat të skaduar të cilat duhet trajtuar (shkatërruar) me metoda dhe në mënyrë specifike. Po ashtu sasi të konsiderueshme gjenden të magazinuara edhe në hapësirat e spitaleve të Kosovës. Janë bërë përpjekje që shkatërrimi i barnave të bëhet në vatrat e blloqeve të KEK-ut, por përkundër marrëveshjes së firmosur nga KEK-u dhe Departamenti Farmaceutik i MSH, kjo nuk u realizua. Vlen të theksohet se edhe barnat e papërdorura të pacientëve që shërohen në shtëpi, janë një ndotje mjaft serioze.

Tabela 14: Sasia e barërave me afat të skaduar në Kosovë [25]

Sasia	**Institucioni shëndetësor/ kompania**	**Lokacioni**
200 kg	Barnatorja qendrore	Prishtinë
2 ton	Shtëpia e shëndetit	Ferizaj
200 kg	Genti Farm (barnatore)	Qagllavicë
10 ton	Shtëpia e shëndetit	Shtime
15 ton	Depo të Farmakosit	Prizren
5 ton	Shtëpia e shëndetit	Dardane
3 ton	Shtëpia e shëndetit	Shtërpcë
5 ton	QMF (Shtëpia e shëndetit)	Prizren
5269 copë ampula	Depoja e komp. Agani	Prishtinë
8729 copë antibiotik	Depoja e komp. Agani	Prishtinë
1236 cope tableta	Depoja e komp. Agani	Prishtinë
4581 copë shurupe	Depoja e komp. Agani	Prishtinë
98555 copë plastikë	Depoja e komp. Agani	Prishtinë
7243 copë qajra	Depoja e komp. Agani	Prishtinë
143 copë insekticide	Depoja e komp. Agani	Prishtinë
10 ton	Depoja qendrore e barnave nga lista speciale	Milloshevë

2.4. MBETURINAT E HIRIT

Deponia e hirit e TC A së bashku me djerrinat dhe lagunën, kapin një sipërfaqe prej rreth 234 ha. Në kuadër të projektit për pastrim dhe rikultivim të tokave (PPRT), projekt i financuar nga Banka Botërore dhe Qeveria Holandeze dhe i zbatuar nga KEK-u, ndër të tjera parashihet dhe stabilizimi, riformimi dhe mbyllja e kësaj deponie. Zbatimi i këtij projekti pritet të filloji kah mesi i vitit 2009. Komponent tjetër me rëndësi e këtij projekti është edhe rikultivimi i djerrinës jugore (në jug

25 Raporti i gjendjes se Mjedisit 2008

të minierave aktuale të linjitit), djerrinës në perëndim të Bardhit dhe në Vasilevë. Po ashtu KEK do të ndihmohet në transformimin e sistemit të transportit të hirit, duke kaluar nga transporti aktual i hirit me shirita në atë hidraulik dhe duke transportuar në minierën e zbrazur të Mirashit lindor. Transporti i hirit nga TC B tanimë që nga viti 2006 kryhet me gypa, në formë hidraulike, dhe deponohet në zbrazëtirat e minierës sipërfaqësore Mirashi lindor.

Mesatarisht TC-et A dhe B, bashkë, prodhojnë më shumë se 1 milion ton të hirit në vit. Nga kjo sasi rreth 700.000 ton, janë të depozituara në deponitë e hirit, ndërsa 300.000 ton, lirohen në ajër.

Tabela 15: Sasia e hirit të prodhuar nga termocentralet e KEK-ut sipas viteve[26]

	2006	2007	2008
Sasia e hirit të prodhuar nga termocentralet e KEK-ut (vit/ton)	1048136 t	1161455 t	1161171 t

Tabela 16: Përmbajtja në % e hirit sipas komponentëve përbërëse

Analizat e hirit	%
SiO2	38
Al_2O_3	6.8
Fe_2O_3	5.4
CaO	35
MgO	18
SO_3	8.3

Sasia e Skories gjatë vitit 2008 në Fe- Ni është 730 000 ton[27]



Foto: Mbeturinat e hirit te Fero-Nikelit

26 Korporata Energjetike e Kosovës
27 Raporti i gjendjes së mjedsit në Neë Co Ferronikelit

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

2.5. MBETURINAT E NDËRTIMIT

Pas përfundimit të luftës, Kosova është përballur edhe me rritjen e sasisë së mbeturinave me prejardhje nga rrënimi i objekteve të banimit dhe objekteve tjera. Hedhja dhe grumbullimi i tyre në vende që nuk kanë qenë të destinuara për këtë qëllim ka keqësuar edhe më shumë gjendjen në sektorin e mbeturinave. Sidomos është shqetësuese dukuria e zënies së sipërfaqeve të tokave të punueshme dhe hedhja e mbeturinave pranë brigjeve të lumenjve. Përveç dëmtimit të peizazhit, mbeturinat e ndërtimit kanë ndikim të dëmshëm në mjedis e veçanërisht në ekosisteme, sidomos në rastet kur ato hedhen të përziera me mbeturinat të tjera urbane. Deri me tani nuk ka të dhëna të sakta për sasinë e këtyre mbeturinave dhe sipërfaqeve të zëna me to, por nga vizitat monitoruese në terren të ekipeve të AKMM-se, është vërejtur se këto mbeturina janë evidente në shumë lokacione të Kosovës. Për ilustrim po paraqesim disa foto me mbeturinat e ndërtimit.





Foto 1 dhe 3 : Mbeturinat e ndërtimit në Suharekë dhe në Deçan

2.6. LLOJET TJERA TË MBETURINAVE

Automjetet mbeturinë - Janë të gjitha llojet e automjeteve motorike që dalin nga përdorimi. Grumbullimi i automjeteve të hedhura bëhet nga disa kompani private. Këto kompani, automjetet mbeturinë, i trajtojnë në dy mënyra: duke i grumbulluar si mbeturina metalike për shitje, të cilat kryesisht shiten në vende të rajonit si dhe duke i demontuar për ripërdorimin e pjesëve të tyre.

Me qëllim të parandalimit dhe reduktimit të ndotjes së mjedisit nga automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre, MMPH ka nxjerr Udhëzimin Administrativ nr. 02/2009 për administrimin e automjeteve të hedhura dhe mbeturinave të tyre. Ky udhëzim përveç parandalimit dhe reduktimit të ndotjes së mjedisit nga automjetet e hedhura dhe mbeturinat e tyre ka për qellim që të ndikojë edhe në:

- rritjen e nivelit të ripërdorimit, riciklimit dhe formave te tjera te përpunimit të automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre në funksion të mbrojtës së mjedisit,
- krijimin e sistemit të grumbullimit, transportit dhe trajtimit të automjeteve mbeturinë dhe komponentëve te tyre dhe
- caktimin e kushteve të përshtatshme për magazinimin e automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre.

Një masë tjetër ligjore në parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga automjetet mbeturinë është vendimi i Qeveris së Republikës së Kosovës i datës 19 qershor 2009, i cili obligon të gjitha pikat e grumbullimit të hekurishteve të largohen nga rrugët magjistrale së paku 1 kilometër dhe që të gjitha veprimtaritë që merren me shitjen e auto pjesëve nga automobilat e përdorur, qe bëjnë mbledhjen, grumbullimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga konstrukti dhe demolimi, të kujdesen për vendosjen e këtyre materialeve në objekte të mbyllura, si dhe të kujdesen për pamjen estetike të tyre.



Foto 4: Vendgrumbullim për automjetet mbeturina

Gomat mbeturinë- Gomat e automjeteve nuk kategorizohen si mbeturinë e rrezikshme, por disa lloje specifike të gomës mund të kenë përbërës të tretshëm dhe të rrezikshëm. Pas 40.000 km. udhëtim gomat e automjetit duhet të zëvendësohen, kështu që për një vit dalin jashtë përdorimit me dhjetëra mijëra goma automjetesh.

Nga djegia e pakontrolluar e gomave lirohen substanca të rrezikshme për mjedisin si p.sh dioksina. Djegia e gomave të automjetit shoqërohet me shumë nxehtësi, për këtë arsye, përdoren si lëndë djegëse për prodhimin e çimentos. Nëpërmjet temperaturës prej 1000 gradë celsius që arrihet në këto furra, dyoksidi i squfurit që lirohet lidhet me çimenton dhe në këtë mënyrë ai bëhet i padëmshëm, ndërsa djegia e gomave në furra joadekuate për pjekjen e gëlqeres paraqet rrezik për mjedisin dhe shëndetin .

Gomat e përdorura të automjeteve në vendin tonë importohen ose grumbullohen me qëllim të ripërpunimit përmes ri-veshjes së tyre, dhe disa kompani mbeturinat e mbetura nga ri-veshja e gomave i shfrytëzojnë për prodhimin e produkteve të ndryshme nga goma. Deri më tani asgjësimi përfundimtar i gomave të përdorura nuk është bërë në mënyrë të organizuar nga institucionet duke marrë parasysh kriteret për mbrojtjen e mjedisit. Asgjësimi i gomave bëhet në mënyrë spontane, në shumicën e rasteve në vendbanime, duke mos respektuar asnjë kriter të mbrojtjes së mjedisit.

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit



Foto 5: Vendgrumbullim i gomave mbeturinë

Vajrat mbeturinë - Mbeturina mjaft problematike janë vajrat e përdorura , të cilët janë ndotësit më potencial të dheut dhe ujërave në Kosovë. Vajrat hedhen dhe derdhen në çdo vend, në rrugë, në punëtori, bile edhe në oborre të shtëpive, ato ndizen në vatra të thjeshta për ngrohjen e lokaleve, punëtorive etj. Në vendin tonë vajrat e përdorura ende nuk grumbullohen dhe nuk trajtohen.

Fabrika "Silcapor" në Kaçanik e përdor vajin e përdorur për lyerjen e kallëpeve. Po ashtu, ende nuk kemi një pasqyrë reale të gjendjes së prezencës së vajrave dhe mbeturinave me përmbajtje të PCB, PCT dhe PBB, të cilat janë të njohura me rrezikshmëri shumë të madhe për shëndetin dhe mjedisin. Brenda vitit në Kosovë përafërsisht vaj mbeturinë krijohen 1.749.700 litra, duke mos llogaritur sasinë e vajit të automjeteve të KFOR-it dhe misioneve të tjera ndërkombëtare në Kosovë.



Foto 6: Vendgrumbullim i ambalazhit te vajrave ne Ballkanin e Suharekës

Bateritë e hedhura dhe të shpenzuara -Mbeturina me rrezik të lartë për mjedisin janë edhe bateritë të cilat hasen kudo në Kosovë. Ekzistojnë shumë lloje baterish të cilat konstruktohen nga materiale të ndryshme dhe të mbushura me elektrolit të llojllojshëm. Shumica e metaleve dhe elektroliteve të baterive janë të njohura me veti toksike të larta dhe kancerogjene.

Disa bateri të automjeteve grumbullohen në qendrat grumbulluese të mbeturinave metalike, mirëpo një sasi e madhe e tyre dhe llojet e tjera të baterive kryesisht hedhen pa kriter. Bateritë e konsumuara janë mbeturina që kërkojnë trajtim të veçantë.

Mënyra se si veprohet me to paraqet ndotje të vazhdueshme dhe rrezikshmëri shumë të lartë. Riciklimi i baterive të automjeteve bëhet në "Trepçë" –Zveçan.

3. GJENDJA DHE ADMINISTRIMI I MBETURINAVE

3.1. Gjenerimi i mbeturinave

Siç shihet nga të dhënat e prezantuara në tabelën 17, sasia më e madhe e mbeturinave gjatë vitit 2007, është deponuar në deponinë e Prishtinës (61.644.35 ton), ndërsa sasia më e vogël është grumbulluar në deponinë e Lypjanit (5.228).

Të dhënat e prezantuara në tabelën 18, tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave gjatë vitit 2008, është deponuar në deponinë e Prishtinës (80.185.06 ton), ndërsa sasia më e vogël është grumbulluar në deponinë e Pejës (21.667 ton).

Duke krahasuar të dhënat për mbeturinat e deponuar në deponitë sanitare për vitin 2007 dhe 2008 vërehet se në të gjitha deponitë regjionale dhe komunale ka pasur sasi më të mëdha të deponimit të mbeturinave. Nga kjo mund të konkludohet se edhe sasia e gjenerimit të mbeturinave ka qenë me e madhe gjatë vitit 2008, kjo njëherazi ka rezultuar edhe me rritje të sasisë së mbeturinave të grumbulluara dhe të deponuara.

Tabela 11: Sasia ditore dhe vjetore e mbeturinave për banor[28]

Llojet e mbeturinave	Mesatarja ditore në kg. / banorë	Sasia vjetore Kg./ banorë	Sasia vjetore në tonelata
Mbeturinat e amvisërisë	0.277	101	232541
Mbeturinat komerciale	0.250	91.25	209875
Mbeturinat medicinale	0.0024	0.876	2014.5
Mbeturinat e hirit dhe ngjyrës	0.907	331	761426.5
Mbeturinat e ndërtimit/ shkatërrimit	0.200	73	167900
Mbeturinat tjera (ambalazh)plastikë, gomë, pesticide, elektronikë, dru etj.	0.360	131.4	302220
Total	**2.05**	**729**	**1675977**



Figura 1: Mbeturinat sipas llojeve në Kosovë (%)

28 Raporti i gjendjes se mjedisit, 2008

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Tabela 17. Sasia e mbeturinave komunale në deponitë sanitare regjionale dhe komunale për vitin 2007 të shprehura në ton[29]

Nr.	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në ton
1	Prishtinë	3,665.45	4,273.73	5,032.07	5,017.46	5,239.63	4,854.54	4,938.13	5,264.28	5,005.82	6,256	6,413	5,703.9	61,664.35
2	Gjilan	6,542.97	5,668.02	2,959.12	4,515.92	4,359.10	3,451.13	3,915.47	4,251.47	3,858.33	4,186	3,585	3,342.09	49,940.08
3	Prizren	2,160.90	1,662.70	2,051.45	2,503.50	2,980.40	2,890	3,407	3,975	3,501	2,546	3,033	2,054.29	32,755.92
4	Podujevë	628.60	529.70	359.56	306.50	481.70	408.78	361.40	931.92	601.70	599.05	591.15	493.27	6.239.33
6	Pejë	1341.5	1200.4	1371	1463.5	1574.6	1279.2	1642.9	1887.6	1628.5	1685.4	1582.7	1603.4	18,260.70
7	Sharr	322	301	343	350	427	434	560	616	420	427	410	407	4,242.00
8	Mitrovicë													28,420
9.	Lypjan													5.228
	Totali	14.661.42	13.632.55	12.116.20	14.156.88	15.062.43	13.317.65	14.824.90	16.962.27	15.015.35	15.699.45	15.614.85	13.603.95	

Tabela 18. Sasia e mbeturinave komunale në deponitë sanitare regjionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2008 të shprehura në t[30]

Nr.	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë*	5,904.90	5,826.06	6,250.23	6,665.96	6,377.97	7,032.28	7,712.59	7,247.91	6,114.45	7,423.37	6,351.12	7,278.22	**80,185.06**
2	Gjilan*	3,761.95	3,458.24	3,921.32	4,292.87	4,193.99	4,193.99	5,019.77	5,409.19	5,260.02	5,334.07	4,060.22	3,818.44	**52,120.75**
3	Prizren*	2,745.79	2,668.20	2,797.85	3,390.01	3,370.20	3,180.02	3,950.10	4,153.40	4,097.90	3,762.70	3,113.40	3,344.56	**40,574.13**
4	Podujevë*	340.89	50.79	213.37	375.06	227.33	299.00	318.23	398.64	372.74	422.58	406.79	437.22	**3,862.64**
6	Pejë**	1,664	1,415	1,464	1,544	1,590	1,685	2,237	2,225	2,225	2,227	1,601	1,800	**21,677**
7	Sharr													
8	Mitrovicë**	2,461	2,587	2,171	2,447	2,719	2,477	2,823	3,118	2,836	2,740	2,677	2,672	**31.727**
9	Ferizaj*	1,531.20	1,447.00	1,368.75	1,605.40	1,656.81	1,638.00	1,852.62	1,938.12	1,958.13	1,969.26	1,478.60	1,507.23	**19,951.12**
	Totali	18.409.73	17.452.29	18.186.52	20.320.30	20.135.30	20.505.29	23.913.31	24.490.26	22.864.24	23.878.98	19.688.13	20.857.67	

29 *KMDK 2008, **ZRRUM 2008
30 *KMDK 2009, **ZRRUM 2009



Figura 8: Sasia e deponimit të mbeturinave komunale në deponitë sanitare për vitin 2008

Nga figura 8 vërehet se sasia më e madhe e mbeturinave të grumbulluara gjatë vitit 2008, ka qenë në deponitë regjionale të Prishtinës dhe të Gjilanit, ndërsa sasia më e vogël në deponinë sanitare të Podujevës dhe në atë të Ferizajt.

Ndërsa nga figura 9 shihet se gjatë periudhës 2006-2008, është rritur në mënyrë progresive sasia e mbeturinave të grumbulluara në deponi. Nga kjo mund të konkludohet se është shënuar progres në procesin e grumbullimit në deponi.



Figura 9: Sasia e deponimit të mbeturinave komunale në deponitë sanitare sipas viteve (2006-2008)

Tabela 19: Sasia e deponimit të mbeturinave për banor (kg/vit) sipas regjioneve[31]

Nr	Regjioni	Sasia e mbeturinave/ ton	Numri i banorëve[2]	Sasia e mbeturinave për banor (kg/vit)
1.	Prishtinë	84,047.70	892,506	94
2.	Prizren	40,574.13	423,797	96
3.	Pejë	21,677	383,494	56
4.	Mitrovicë	31.727	316,975	100
5.	Gjilan	52,120.75	366,442	142
Mesatarja		**46.029**		**97.6**

31 Sasia e mbeturinave të grumbulluara në deponi është prezantuar sipas të dhënave nga KMDK dhe ZRRUM, ndërsa numri i banoreve sipas të dhënave nga OSBE 2004.

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit



Figura 10: Sasia e deponimit të mbeturinave për banor (kg/vit) sipas regjioneve

Nga tabela 19, vërehet se duke u bazuar në sasinë e përgjithshme të mbeturinave të grumbulluara në deponi, mesatarja e sasisë vjetore të mbeturinave për banorë është 97.6 kg. Sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara për banorë ka qenë në regjionin e Gjilanit (142 kg), ndërsa ajo më e vogël në regjionin e Pejës (56 kg).

Në tabelën 20, vërehet se sasia mesatare e deponimit të mbeturinave komunale në Kosovë për kokë banori është 0.4 kg në ditë. Në regjionin e Prishtinës kjo sasi është 0.9 kg, ndërsa për regjionet tjera është 0.3 kg.

Tabela 20: Mesatarja ditore e sasisë së mbeturinave komunale të deponuara në Kosovë (kg/banorë) [32]

Regjioni	Sasia e grumbulluar (1000 ton)	Nr i popullsisë[3]	Mesatarja ditore (kg/ banorë)
Regjioni i Prishtinës	182	500 000	0.9
Regjionet tjera	148	1 600 000	0.3
Gjithsej	330	2 100 000	0.4

Të dhënat e prezantuara në figurën 11, tregojnë se mesatarja vjetore e sasisë së mbeturinave të deponuara për banorë është 157 kg. Në regjionin e Prishtinës kjo mesatare është 332 kg, ndërsa në regjionet tjera 95 kg.



Figura 10: Mesatarja vjetore e gjenerimit të mbeturinave në Kosovë (kg/banor)[33]

Përqindja e përgjithshme e deponimit të mbeturinave në deponitë e licencuara për vitin 2007 dhe 2008 është 89 % përkatësisht 83 %.

32 Anketa e Mbeturinave Komunale, Enti i Statistikave të Kosovës 2007
33 Anketa e Mbeturinave Komunale, Enti i Statistikave të Kosovës 2007

3.2. DEPONITË E MBETURINAVE

3.2.1. Deponitë e Vjetra të Mbeturinave Komunale

Prej 29 komunave të Kosovës, 26 prej tyre, prej shumë vitesh kanë pasur deponi (fushë-hedhurina) mbitokësore komunale. Shumica e këtyre deponive nuk i kanë plotësuar as standardet minimale. Për këtë arsye, sot paraqesin problem dhe janë sfidë për institucionet dhe shoqërinë kosovare. Këto deponi, janë afër vendbanimeve dhe rrjedhave të lumenjve si p.sh. deponia e Lipjanit (foto 6). Distanca me lumin është 10 deri 20 metra. Shumica e këtyre deponive paraqesin rrezik permanent për mjedisin, sidomos për ujërat nëntokësore.

Në këto deponi hedhen mbeturina të të gjitha llojeve të mundshme si: mbeturina organike, plastikë, metale, vajra, acide, bateri, mjete medicinale e çka jo tjetër.

Vendosja e mbeturinave në këto deponi është bërë pa planifikim. Mbeturinat janë hedhur dhe deponuar aty ku ka qenë më lehtë. Kompaktimi i mbeturinave para lufte, te këto deponi, nuk është bërë fare, sidomos te deponitë e qyteteve të vogla, mirëpo pas luftës, falë donacioneve të AER-it dhe disa organizatave ndërkombëtare, deponitë janë në një situatë më të volitshme. Prapë se prapë, këto deponi nuk kanë kurrfarë sistemi të drenazhimit, prandaj gjithmonë ujërat nëntokësore janë të rrezikuara nga kullimi i ujit të ndotur të mbeturinave. Sidomos, janë shumë të rrezikuara ujërat e puseve (bunarëve) të vendbanimeve që gjinden në afërsi të këtyre deponive dhe që shfrytëzohen për pije nga banorët.



Deponia e vjetër e Prishtinës

Në shumicën e këtyre deponive ka ende djegie të mbeturinave. Këto ndodhin si pasojë e vetëndezjes (nga temperaturat e larta), por edhe të ndezjes nga qytetarët.

Në të gjitha deponitë e vjetra, operojnë qytetarët që bëjnë grumbullimin e disa mbeturinave, të cilat pastaj i shesin. Këta qytetarë, grumbullojnë mbeturinat e letrës, kanoçeve të aluminit, metalet dhe mbeturinat e drurit.

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Karakteristikë tjetër te këto deponi është kundërmimi i fortë gjatë sezonit të verës, kjo ndodh sepse mbeturinat mbulohen shumë rrallë me shtresa dheu.

Shumica e këtyre deponive janë mbyllur, por në mungesë të deponive të reja rajonale, prapë kanë filluar të shfrytëzohen. Si shembull mund të përmendim deponitë e mbyllura në: Lipjan, Prizren, Besianë dhe Prishtinë. Ndërsa deponitë që nuk shfrytëzohen dhe janë lënë në mëshirë të fatit, janë deponitë e vjetra në: Gjilan, Dardanë, Artanë, Viti, Ferizaj, Klinë, Besianë etj. Deponitë të cilat janë sanuar nga AER-i janë: deponia e Kastriotit, Deçanit, Pejës, Shtimes, Vushtrrisë, ndërsa mbyllja e deponisë komunale të Therandës, është financuar nga Kuvendi Komunal dhe është realizuar në bashkëpunim me ndërmarrjen publike „Komunalja“ të Therandës.

Kjo është masa e parë e mbylljes vullnetare të deponisë në Kosovë, e cila është aranzhuar në bashkëpunim të ngushtë në mes të komunës dhe kompanisë përgjegjëse, e iniciuar nga GTZ- ja, projekti i administrimit të mbeturinave.

3.2.2. DEPONITË SANITARE REGJIONALE DHE KOMUNALE

3.2.2.1. Deponia Regjionale- Gjilan

Komunat që i përfshinë kjo deponi janë: Gjilani, Kamenica, Vitia, Novobërda, Kaçaniku, Shtimja dhe Ferizaj. Madhësia e deponisë është 24 ha. Kohëzgjatja e kësaj deponie është 15 vjet. Kapaciteti total është 1.200 000 m^3, ndërsa kapaciteti mujor 4 000 T. Gjendja në këtë deponi nuk është e mirë, sistemi i pompimit nuk funksionon rregullisht dhe si pasojë e kësaj bëhet përzierja e ujërave sipërfaqësore me ato të deponisë.



Foto 7: Deponia regjionale e Gjilanit

3.2.2.2. Deponia Komunale -Podujevë

Kjo deponi përfshinë lokalitetet e komunës së Podujevës. Madhësia e deponisë është 5 ha. Kohëzgjatja e kësaj deponie është 15 vjet. Kapaciteti total është 925 000 m^3, ndërsa kapaciteti mujor 2000 T. Edhe në këtë deponi gjendja nuk është e mirë, si pasojë e përzierjes së ujerave të deponisë me ujërat sipërfaqësore rrjedhëse.



Foto 8. Deponia Regjionale-Podujevë

3.2.2.3. Deponia Regjionale-Prizren

Kjo deponi përfshinë territorin e komunës së Prizrenit, Rahovecit, Malishevës dhe Suharekës. Madhësia e deponisë është 25 ha. Kohëzgjatja është 15 vjet. Kapaciteti total është 2.600 000 m^3, ndërsa kapaciteti mujor 3500 T. Edhe në këtë deponi nuk funksionon sistemi i pompimit, gjithashtu baseni ku behet grumbullimi i ujërave të deponisë është çarë dhe paraqet rrezik për daljen e rrjedhës nga kontrolli duke rrezikuar ndotjen e ujërave nëntokësore dhe banorët që jetojnë në afërsi të kësaj deponie. Presimi i mbeturinave nuk bëhet sipas rregullave nga menaxhuesit e kësaj deponie.





Foto 9 dhe 10: Deponia regjionale-Prizren

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

3.2.2.4. Deponia Regjionale-Prishtinë (Mirash)

Në kuadër të kësaj deponie bëhet grumbullimi i mbeturinave për komunat: Prishtinë, Obiliq, Lipjan. Fushë Kosovë dhe Drenas (Gllogoc). Madhësia e përgjithshme e kësaj deponie është rreth 40 ha. Kohëzgjatja e deponisë është 15 vjet. Kapaciteti total është 3.500 000 m^3, ndërsa kapaciteti mujor 6 000 T. Gjatë vizitave monitoruese në këtë deponi është konstatuar se gjendja është mjaft e rëndë si pasojë e keq menaxhimit të deponisë. Pompat për trajtimin e rrjedhës nuk janë futur në përdorim, minimumi që 6 muaj. Si pasojë e kësaj ka ardhur deri të përzierja e rrjedhjes me ujërat sipërfaqësore. Në këtë deponi ka një kundërmim të rëndë dhe ekzistojnë parakushte për përhapjen e sëmundjeve dhe epidemive të ndryshme.




Foto 11 dhe 12 : Deponia regjionale e Prishtinës

3.2.2.5. Deponia Regjionale-Pejë

Komunat që i përfshinë kjo deponi janë: Peja, Deçani, Klina dhe Istogu. Madhësia e deponisë është 3.6 ha . Kapaciteti total është 1.500 000 m^3, ndërsa kapaciteti mujor 2 400 T. Gjendja aktuale dhe menaxhimi i kësaj deponie është jo i mirë. Edhe në këtë deponi bëhet përzierja e ujërave sipërfaqësore me rrjedhën e deponisë.



Foto 13. Deponia regjionale e Pejës

3.2.2.6. Deponia Regjionale-Mitrovicë

Kjo deponi përfshinë Mitrovicën, Vushtrrinë, Zubin Potokun dhe Skenderajn. Madhësia e deponisë është 7 ha. Kapaciteti për 250 000 banorë. Kohëzgjatja është 15 vjet. Kapaciteti total është 2.000 000 m^3, kapaciteti mujor 2 400 T. Kjo deponi gjendet afër fshatit Gërmovë. Me ndihmën e organizatës qeveritare DANIDA nga Danimarka, është bërë rehabilitimi i saj. Deponia përfshinë afro 7 hektarë dhe mund të shfrytëzohet edhe për dhjetë vitet e ardhshme. Me rajonalizimin e ndërmarrjeve publike, kjo deponi, është paraparë të shfrytëzohet edhe nga komunat: Vushtrri, Zubin Potok dhe Skenderaj. Për momentin, kjo deponi, në mënyrë të rregullt, shfrytëzohet vetëm për komunën e Mitrovicës dhe Vushtrrisë, ndërsa për Zubin Potok dhe Skenderaj, shfrytëzohet herë pas here.



Harta 3: Shtrirja e deponive regjionale

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

3.2.2.7. Deponia Komunale Sharr

Kjo deponi përfshinë vetëm komunën e Sharrit (Dragashit). Madhësia e deponisë është 1.2 ha. Kohëzgjatja është 15 vjet. Kapaciteti total është 50 000 m^3, ndërsa kapaciteti mujor 20 T . Edhe pse është llogaritur deponi me standarde minimale, nuk i plotëson kushtet, pasi që gjysma e saj nuk është e mbuluar me shtresën izoluese si dhe ujërat e zeza nuk kanë asnjë tretman.



Foto 14: Deponia e Sharrit

3.2.2.8. Stacioni Transferues Ferizaj

Komunat që janë paraparë për shfrytëzimin e këtij stacioni transferues janë: Ferizaj, Shtimja, Kaçaniku dhe Hani i Elezit. Kapaciteti total 50 000 m^3, kurse kapaciteti mujor 2 500 T

3.2.2.9. Deponia Komunale e Fushë Kosovës

Edhe gjendja e kësaj deponie nuk është e mirë. Ajo paraqet burim të rrezikut për shëndetin e popullatës që banon afër kësaj deponie. Ujërat e zeza që rrjedhin nga kjo janë paraqesin veçanërisht një rrezik potencial për banorët e kësaj zone.



Foto 15: Deponia në Fushë Kosovë

3.2.2.10. Deponia Komunale e Zveçanit

Deponia e Zveçanit është hapur në vitin 2003. Edhe kjo deponi është ndërtuar me donacion nga AER-i. Deponia ka sipërfaqe prej 3.5 hektarësh, apo 35.000 m^2 hapësirë të shfrytëzueshme, ndërsa e tërë sipërfaqja e deponisë është mbi 4 hektarë. Deponia është paraparë të shfrytëzohet nga komuna e Zveçanit, Albanikut dhe Mitrovicës. Për momentin, shfrytëzohet vetëm nga Zveçani dhe Mitrovica, ndërsa Albaniku ende e shfrytëzon deponinë e vjetër komunale. Deponia është paraparë të shfrytëzohet për 12 vjet. Administrohet nga ndërmarrja publike e Zveçanit e cila brenda muajit pranon 800 deri 1.000 ton mbeturinë komunale apo 1.500 m^3.



Foto 16. Deponia Komunale në Zveçan

Tabela 21: Deponitë sanitare, kapaciteti dhe sipërfaqja tyre

Deponitë Sanitare	Komunat e mbuluara me shërbim	Tipi i Deponisë	Sipërfaqja (ha)	Banorë	Periudha kohore
Prishtinë	Prishtinë, Lipjan, Obiliq, Gllogoc, Fushë-Kosovë.	Regjionale	40	724.251	15
Gjilan	Gjilan, Viti, Ferizaj, Kamenicë,Novobërdë	Regjionale	24	242.195	15
Prizren	Prizren, Suharekë, Malishevë, Rahovec, Gjakovë	Regjionale	24	316.728	15
Podujevë	Podujevë	Komunale	5	131.300	15
Mitrovicë	Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj	Regjionale	7	250.000	15
Pejë	Pejë, Deçan, Klinë, Istog	Regjionale	3.6	250.000	

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Sharr	Sharr	Komunale	1.2	27.000	16
Ferizaj	Ferizaj, Kaçanik Shtime, Shtërpcë, Hani i Elezit	Stacion Transferi		210.120	
Zveçan	Zveçan	Komunale			15



Harta 4: Deponitë e mbeturinave

3.3. DEPONITË INDUSTIRALE

Shumë substanca të rrezikshme industriale kanë mbetur të deponuara nëpër deponi të ndërmarrjeve industriale që i kanë prodhuar ose përdorur ato mbeturina. Në shumicën e rasteve ndërmarrjet që posedojnë këto substanca nuk kanë vullnet dhe as mjete për trajtimin e tyre dhe reduktimin e rrezikut nga to.

Në Tabelën 22 janë paraqitur të dhëna për sipërfaqen dhe sasinë e mbeturinave në disa nga deponitë industriale.

Tabela 22: Sipërfaqet dhe sasia e mbeturinave ne deponit e mbeturinave industriale

Nr.	**Lokacioni**	**Sipërfaqja e deponisë e shprehur në ha**	**Sasia e shprehur mili.ton**
1	Djerrina në PIM	35	1.52
2	Djerrina Zvecan (Gornje polje)	50	12
3	Djerrina Leposaviq (Bostaniste)	10	3.6
4	Djerrina Kizhnica (Badovc)	18	7.7
5	Djerina Stan-terg (Zarkov potok)	10	3.6
6	Deponia e hirit dhe zgjyrës në KEK	160	42
	Totali	**283**	**70.4**



Figura 12: Deponit industriale sipas siperfaqes (ha)



Foto 17: Deponia industriale në Kishnicë

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

3.4. HOT-SPOTET E MBETURINAVE DHE MATERIEVE TË RREZIKSHME

Për hot-spotet ekzistojnë definicione të ndryshme në terminologjinë e mjedisit varësisht se në çfarë fushe mjedisore perceptohet hot-spoti. Një ndër definicionet është ai që hot –spotet i paraqet si lokacione me koncentrim të lartë të ndotësve. Hot-spotet mund te jenë edhe toka të kontaminuara kimikisht nga industritë e minierave, aktivitetet me mbeturina, dhe ndotës tjerë që kanë ndikim në ujërat nëntokësore, tokë dhe ajër. Në Kosovë janë evidentuar 110 hot-spote, si lokacione që janë të kontaminuara nga metalet e rënda, produktet kimike, vajrat e përdorura dhe ndotës tjerë.

Tabela 23: Hot-spotet kryesore te mbeturinave sipas komunave dhe lokacioneve

Nr.	Komuna/ Lokacioni	Hot-spotet		
		Deponitë e mbeturinave komunale	Deponitë me mbetje të fabrikave	Deponitë me materie tjera
1.	Prishtinë	1	1	1
2.	Prizren	2	-	1
3.	Gjilan	1	-	2
4.	Pejë	1	-	6
5.	Gjakovë	1	-	4
6.	Ferizaj	-	1	-
7.	Podujevë	2	-	3
8.	Fushë Kosovë	2	1	2
9.	Lipjan	2	-	1
10.	Therandë	1	-	2
11.	Drenas	1	-	1
12.	Vushtrri	-	2	-
13.	Kaçanik	1	-	2
14.	Graçanicë-Kishnicë	-	8	-
15.	Skenderaj	-	1	-
16.	Artanë	-	4	-
17.	Istog	1	4	1
18.	Malishevë	-	-	-
19.	Rahovec	1	1	3
20.	Deçan		4	-
21.	Viti	1	2	2
22.	Kamenicë	3	-	3
23.	Klinë	-	-	-
24.	Dragash	2	1	-
25.	Suharekë	-	1	-
26.	Obiliq	-	2	2
27.	Mitrovicë	-	2	11

Në kuadër të deponive të mbeturinave të prezantuara në këtë tabelë janë përfshirë vendet e deponive sanitare dhe deponitë e mbuluara komunale.

Në kuadër të deponive me mbetje të fabrikave janë përfshirë vendet ku janë të koncentruar fabrikat prodhuese, apo ato që kanë prodhuar në ish sistemin e mëparshëm. Ndërsa në kuadër të deponive tjera janë përfshirë vendet si deponitë e minierave, fermat e ndryshme, deponitë e agrikulturës-pesticideve, kooperativat bujqësore, deponitë industriale etj.





Foto: 18 dhe 19 Hot-spote potenciale të mbeturinave në Drenas dhe Ferizaj

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit



Harta 5. Lokacionet e hot-spoteve potenciale të mbeturinave, materieve të rrezikshme dhe hot-spotet tjera

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

4. TRAJTIMI I MBETURINAVE

4.1. Koncepti i trajtimit të mbeturinave

Nuk mund të flasim për ndonjë trajtim të mirëfilltë të mbeturinave në Kosovë. Në përgjithësi, përpjekjet dhe iniciativat kanë qenë të vogla. Bota e zhvilluar ka krijuar konceptin e trajtimit të mbeturinave të cilit medoemos duhet t`i përmbahemi dhe të fillojmë realizmin në vendin tonë: Trajtimi i mbeturinave në Kosovë ka filluar hapat e parë të vegjël. Ato janë në shkallën e vetiniciativave, por paraqesin rëndësi të veçantë. Përkrah hapave fillestarë të trajtimit të mbeturinave, është duke u vënë një bazë e shëndoshë në strukturimin dhe krijimin e sistemit menaxhues të tyre. Në Kosovë mbeturinat administrohen nga ZRRUM përmes Ndërmarrjeve Publike. Zonat urbane që përbëjnë 40% të banimeve në Kosovë janë të mbuluara deri 90 %, ndërsa zonat rurale (që paraqesin mbi 60% të vendbanimeve), janë shumë pak të mbuluara me shërbim, diku 10%, me tendencë të rritjes.

Trajtimi i mbeturinave është problem mjaft i komplikuar dhe i shtrenjtë.

Ai ndikon dukshëm në uljen e nivelit të përgjithshëm të mbeturinave. Aktualisht në Kosovë nuk kemi projekte të mëdha që merren me trajtimin e mbeturinave, por nuk mungojnë iniciativat e vogla private që flasin për disa pika trajtimi .

Mund të përmendim riciklimin e plastikës në Rahovec, Mitrovicë, grumbullimin e letrës në Xërxë, Lipjan, Fushë Kosovë, Prizren, Prishtinë, shisheve të qelqit në Pejë, grumbullimi dhe riciklimi i qelqit në Therandë, metaleve të ndryshme në disa qendra të Kosovës (Prishtinë, Ferizaj, Lipjan, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë, Janjevë, Podujevë etj.). Gjithashtu, kohëve të fundit kemi iniciativa edhe për fillimin e kompostimit në disa qendra të Kosovës, ndër të cilat mund të përmendim atë në Klinë.

Aktivitetet e ministrisë janë të fokusuara në parandalimin, grumbullimin, ndarjen, trajtimin (riciklimin, ripërdorimin, kompostimin etj) dhe deponimin e mbeturinave.



Figura 13: Hierarkia e administrimit te mbeturinave

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

4.1.1. Riciklimi i Mbeturinave

Është proces ku krijohen efekte teknike, ekologjike si dhe ekonomike. Rëndësia qëndron në zvogëlimin drastik të sasisë së mbeturinave industriale dhe komunale të cilat dërgohen në deponi. Me këtë zgjatet jeta e deponive dhe minimizohet rreziku për shëndetin dhe mjedisin, gjithashtu zvogëlohet shfrytëzimi i resurseve natyrore, kursehet në kohë dhe energji. Sipas analizave të përbërjes së mbeturinave komunale është konstatuar se 35 – 45 % janë mbeturina organike. Nga kjo rekomandojmë kompostimin dhe fermentimin e mbeturinave organike si procese shumë të lehta dhe që sjellin përfitime të shumëfishta. Në Kosovë rreth 35 ndërmarrje merren me trajtimin e mbeturinave të reciklueshme lehtë, si: letër, metale, bateri, kanoçe, mbeturina organike, goma, plastikë etj

4.1.2. Reduktimi në Burim

Mbeturinat paraqesin një material shumë kompleks dhe heterogjen që formohet gjatë aktiviteteve të përditshme të njeriut në punë, banesë, sipërfaqe publike, shkolla, industri, dyqane dhe aktivitete tjera. Me reduktim në burim nënkuptojmë shfrytëzim sa më efikas të resurseve natyrore, zvogëlim të prodhimeve të panevojshme dhe të planifikuar d.m.th. humbje më të vogël të energjisë. Prodhuesit ta shqyrtojnë mundësinë për ripërdorimin dhe riciklimin e ambalazhit.

4.1.3. Ripërdorimi

Disa prodhime janë të dizajnuara në atë mënyrë që mund të shfrytëzohen disa herë. Përdorimi i serishëm i qeseve të najlonit ose kavanozave të qelqit, janë shembuj të shpeshtë.

Ekzistojnë disa arsye për ripërdorimin e prodhimeve:

- Kursehet në energji dhe lëndë të parë;
- Zvogëlohen shpenzimet për deponim;
- Zvogëlohen shpenzimet për tregtarë dhe konsumatorë,

Në tabelën 24, janë prezantuar të dhëna për format e trajtimit të mbeturinave nga disa kompani/ndërmarrje, llojin e materialit që e riciklojnë, sasinë dhe tregun e shitjes.

Tabela 24. Disa nga kompanitë/ndërmarrjet qe bëjnë trajtimin e mbeturinave në Kosovë[34]

Kompania/ndërmarrja	Lloji i materialit	Sasia	Trajtimi	Tregu i shitjes
Fabrika e letrës dhe kartuçit-Lipjan	Letër	300 T/muaj	Riciklim	Kosovë
Uniteti-Mitrovicë	Letër	15 T/muaj	Grumbullim	Kosovë
Celina- Xërxë, Rahovec	Letër	450 T/muaj	Grumbullim	Maqedoni, Kroaci

34 Gjendja e mbeturinave ne Kosove, MMPH 2005

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Val-Karton- Prishtinë	Letër	100 T/muaj	Grumbullim	Serbi, Bullgari
Meta Company-Fushë-Kosovë	Letër	75 T/muaj	Grumbullim	Serbi, Maqedoni
Hekurishte-Pejë	Hekur,alumin, letër, mesing, plastikë, bateri	150 T/muaj	Grumbullim	
SekKos- Prishtinë	Hekur,alumin, mesing, bateri	20 T/muaj	Grumbullim	Slloveni,Gjermani
Katër Vëllezërit- Skenderaj	Hekur	/ T/muaj	Grumbullim	Kosovë
Ariani- Skenderaj	Hekur,alumin, mesing, bateri	20 T/muaj	Grumbullim	Maqedoni, Greqi
Gratis- Mitrovicë	Hekur	300 T/muaj	Grumbullim	Greqi
Qëndresa- Kamenicë	Hekur	5 T/muaj	Grumbullim	Kosovë
Bosfor- Gjilan	Hekur,alumin, mesing, bateri	10 T/muaj	Grumbullim	Maqedoni, Greqi
Rival-Livoç i Epërm Podujevë	Hekur,alumin, mesing, bateri	/ T/muaj	Grumbullim	Maqedoni,Greqi
Hekurishta-Gjilan	Hekur,alumin, mesing ,bateri	/ T/muaj	Grumbullim	Maqedoni, Greqi
Hekurishte-Livoç i Poshtëm-Podujeve	Hekur,alumin, mesing ,bateri	/ T/muaj	Grumbullim	Maqedoni, Greqi
Evropa Dekor- Podujevë	Alumin,mesing rosfajs etj	0.9 T/muaj	Grumbullim	Kosovë
Metalurgu-Mitrovicë	Hekur,alumin, bakër	10.2 T/muaj	Grumbullim	Kosovë
Tiki-Niti-Prishtinë	Hekur,alumin, mesing ,bateri	2500 T/muaj	Grumbullim	Maqedoni, Greqi, Itali
Profil Metali-Prizren	Hekur,alumin, bakër	9 T/muaj	Grumbullim	Kosovë
Agroklina-Drsnik Klinë	Pemë, perime,dru, plehra organike,	300.000 l brenda ciklit	Kompostim	Kosovë
Fabrika e birrës-Pejë	Krunde të elbit	50000/1 zierje brenda ditës	Grumbullim	Kosovë
Fisi Comerc-Radivoc Viti	Goma të vjetra	550 copë/ muaj	Riveshje	Kosovë
Riveshje e gomave-Vllashnje-Prizren	Goma të vjetra	4 T/muaj	Riveshje	Kosovë
Ekoplast- Rahovec	Plastikë	100 T/muaj	Riciklim	Kosovë
18 Nëntori- Rahovec	Plastikë	8 T/muaj	Riciklim	Kosovë
Pista- Rahovec	Plastikë	20 T/muaj	Riciklim	Kosovë

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit



Foto 20; Grumbullimi i mbeturinave për riciklim

Sipas të dhënave të prezantuara në tabelën 25 dhe në figurën 14, mund të konludohet se sasia më e madhe e mbeturinave që trajtohen në Kosovë është me prejardhje nga metalet, ndërsa sasia me e vogël e ricikluar është e mbeturinave të gomës.

Tabela 25 : Sasia në ton e mbeturinave të trajtuara në Kosovë sipas llojeve

Lloji i materialit	Sasia t/muaj
Metale	3018.9
Letër	940
Plastikë	128
Mbeturina organike	52.5
Gomë	4



Figura 14 : Llojet e mbeturinave që trajtohen në Kosovë (ton/muaj)



Harta 6: Disa pika te trajtimit të mbeturinave në Kosovë

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

5. ASPEKTE TË PERGJITHSHME

5.1. Tarifa për Administrimin e Mbeturinave Komunale

Tarifat për shërbimet e ofruara për grumbullimin e mbeturinave caktohen nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina, duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave (Rregullorja nr. 2004/49) dhe në pajtim me Nenin 26 të Rregullës mbi Rregullimin e Tarifave për Shërbime nga Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Kosovë (Rregulla e ZRRUM R 02/GM e datës 26 janar 2005"). Tarifat caktohen në bazë të kategorive të konsumatorëve dhe në bazë të shërbimeve të ofruara, dhe ato mund të ndryshojnë varësisht nga kompania që ofron shërbime.

Tabela 26: Tabela e tarifave (euro/muaj) për grumbullimin e mbeturinave për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak sipas kompanive regjionale[35]

Nr.	Kompania	Regjioni	Mënyra e ofrimit të shërbimeve	
			Derë-me-derë (Euro/muaj)	**Me kontejner të përbashkët** (Euro/muaj)
1	Ambienti	Pejë	3.04	3.04
2	Çabrati	Gjakovë	3.74	3.74
3	Eko-Regjioni	Prizren	3.65	3.65
4	Higjiena	Gjilan	3.74	3.74
5	Pastërtia	Ferizaj	3.74	3.74
6	Pastrimi	Prishtinë	3.92	3.92
7	Uniteti	Mitrovicë	3.04	3.04

Nga të dhënat e prezantuara në tabelën 26, shihet se tarifat më të larta për grumbullimin e mbeturinave për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak, për të dy shërbimet e ofruara atë "derë me derë" dhe me kontejner të përbashkët, janë ato që ofron kompania regjionale "Pastrimi"Prishtinë, ndërsa me të ulëta ato që ofrojnë kompanitë "Ambienti"Pejë dhe "Uniteti"Mitrovicë.

35 Zyra rregullatore për ujë dhe mbeturina-ZRRUM 2009

Tabela 27: Tabela e tarifave për grumbullimin e mbeturinave për kategorinë e konsumatorëve komercial/ industrial sipas kompanive regjionale[36]

Kompania	Regjioni	Mënyra e ofrimit të shërbimeve						
		Shërbimet e ofruara për kontejner të përbashkët (euro/muaj)				Shërbimet e ofruara për kontejner te veçantë (euro/zbrazje)		
		Zona	**Nënkateg.1** Veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese	**Nënkateg. 2** Veprimtaritë e vogla dhe te mesme komerciale dhe shërbyese	**Nënkateg. 3** Veprimtaritë e mëdha komerciale shërbyese dhe ato prodhuese	**Nënkateg. 1** Veprimtaritë e vogla zejtare dhe shërbyese	**Nënkateg. 2** Veprimtaritë e vogla dhe te mesme komerciale dhe shërbyese	**Nënkateg. 3** Veprimtaritë e mëdha komerciale shërbyese dhe ato
						Vëllimi i kontejnerit		
						1.1 m³	**5.0 m³**	**7.0 m³**
Ambienti	Pejë	I	4.40	7.77	13.82	10.00	n/sh	35.00
		II	4.40	7.77	13.82			
Çabrati	Gjakovë	I	3.74	18.00	n/sh	9.50	n/sh	35.00
		II	2.78	9.70	n/sh			
Eko-Regjioni	Prizren	I	4.20	9.87	17.35	9.00	n/sh	35.00
		II	6.33	ska	ska			
Higjiena	Gjilan	I	4.35	7.83	14.78	9.00	n/sh	n/sh
		II	6.09	9.57	16.25			
Pastërtia	Ferizaj	I	6.09	8.58	15.00	10.00	n/sh	n/sh
		II	n/sh	n/sh	n/sh			
Pastrimi	Prishtinë	I	7.00	10.00	17.25	9.0	n/sh	35
		II	5.00	6.00	11.00			
Uniteti	Mitrovicë	I	5.00	9.00	15.00	9.0	30	35
		II	4.50	6.00	12.50			

Në tabelën 27, janë prezantuar të dhënat për tarifat e grumbullimit të mbeturinave për kategorinë e konsumatorëve komercial dhe industrial. Këto tarifa ndryshojnë varësisht nga shërbimet që ofrohen dhe zonat e shërbimit. Tarifat më të larta për shërbimin e ofruar me kontejner të përbashkët për të dy zonat janë ato që ofrohen nga Kompania "Pastrimi"Prishtinë, ndërsa më të ulëta nga kompania "Ambienti"Pejë.

Kompania "Pastërtia"Ferizaj dhe "Ambientit"Pejë, i kanë tarifat më të larta për shërbimin e ofruar për kontejner të veçantë.

36 Zyra rregullatore për ujë dhe mbetturina-ZRRUM 2009

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Tabela 28: Tabela e tarifave për grumbullimin e mbeturinave për kategorinë e konsumatoreve institucional [37]

Kompania	Regjioni	Mënyra e ofrimit të shërbimeve					
		Shërbimet e ofruara për kontejner të përbashkët (euro/muaj)			Shërbimet e ofruara për kontejner te veçantë (euro/zbrazje)		
		Nënkateg.1 Zyrat e partive politike, zyrat postare, përfaqësi te shoqatave, objekte fetare dhe te ngjashme	**Nënkateg. 2** Shoqata, ambulanca, çerdhe, halla te sporteve, kinema, teatro, galeri, biblioteka dhe te ngjashme	**Nënkateg. 3** Shkolla, posta, spitale, ministri, objekte te kuvendeve komunale, institucione financiare, qendra te studenteve, shtëpi botuese, gjykata, stacione autobusi dhe treni dhe te ngjashme	**Nënkateg.1** Zyrat e partive politike, zyrat postare, përfaqësi te shoqatave, objekte fetare dhe te ngjashme	**Nënkateg. 2** Shoqata, ambulanca, çerdhe, halla te sporteve, kinema, teatro, galeri, biblioteka e te ngjashme	**Nënkateg. 3** Shkolla, posta, spitale, ministri, objekte te kuvendeve komunale, institucione financiare, qendra te studenteve, shtëpi botuese, gjykata, stacione autobusi dhe treni dhe te ngjashme
					Vëllimi i kontejnerit		
					1.1 m³	**5.0 m³**	**7.0 m³**
Ambienti	Pejë	3.04	n/sh	n/sh	10.00	n/sh	35.00
Çabrati	Gjakovë	3.74	n/sh	n/sh	n/sh	n/sh	n/sh
Eko-Regjioni	Prizren	3.65	n/sh	n/sh	9.00	n/sh	n/sh
Higjiena	Gjilan	3.74	n/sh	n/sh	9.00	n/sh	n/sh
Pastërtia	Ferizaj	3.74	n/sh	n/sh	n/sh	30.00	n/sh
Pastrimi	Prishtinë	3.92	n/sh	n/sh	9.00	n/sh	35.00
Uniteti	Mitrovicë	3.04	n/sh	n/sh	9.00	30.00	35.00

Në tabelën 28, janë prezantuar të dhënat për tarifat e grumbullimit të mbeturinave për kategorinë e konsumatorëve institucional. Edhe për këtë kategori, tarifat ndryshojnë varësisht nga shërbimet që ofrohen dhe zonat e shërbimit. Tarifat më të larta për shërbimin e ofruar me kontejner të përbashkët për të dy zonat janë ato që ofrohen nga Kompania "Pastrimi"Prishtinë, ndërsa kompania "Ambienti"Pejë, i ka tarifat më të larta për shërbimin e ofruar për kontejner të veçantë.

37 Zyra rregullatore për ujë dhe mbeturina-ZRRUM 2009

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Tabela 29: Niveli i pagesës për grumbullimin e mbeturinave dhe si i konsiderojnë konsumatorët tarifat për këtë shërbim [38]

Pagesa për grumbullimin e mbeturinave %	
Rregullisht	64.6 %
Kohë pas kohe	25.0 %
Asnjëherë	10.4 %
Numri i respodentëve	948
Si i konsiderojnë konsumatorët tarifat e grumbullimit te mbeturinave %	
Shumë të larta	1.72 %
Të larta	28.49 %
Të përballueshme	66.77 %
Të ulëta	2.04 %
Nuk e di	0.97 %
Numri i respodentëve	930

Në tabelën 29, janë prezantuar të dhëna për nivelin e pagesës për grumbullimin e mbeturinave dhe arsyet për mos pagesë të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave. Siç shihet nga tabela, rreth 64.5 e respodentëve janë deklaruar se i paguajnë rregullisht faturat për grumbullimin e mbeturinave, ndërsa 10.4 % të tyre janë deklaruar se nuk i paguajnë asnjëherë faturat për grumbullimin e mbeturinave. Si arsye për mos pagesën e shërbimeve për mbeturinat pjesa më e madhe e respondentëve (61.3%), kanë deklaruar se është mungesa e mjeteve financiare. Pakënaqësia me shërbimet e ofruara është deklaruar si arsye për mos pagesë në 28.5% të rasteve, ndërkaq mos dërgimi i rregullt i faturave është deklaruar si arsye për mos pagesë në 5.2% të rasteve.

Në anën tjetër shërbimet për grumbullim të mbeturinave nga pjesa më e madhe e respodentëve (66.7 %) konsiderohen të kenë tarifa "të përballueshme", ndërsa 28.4 % e respodentëve i konsiderojnë këto tarifa të larta.

5.2. Infrastruktura për grumbullimin e mbeturinave

Pjesë e rëndësishme e sistemit për administrimin e mbeturinave është edhe infrastruktura për grumbullimin e mbeturinave. Në tabelën 30 janë prezantuar të dhëna për infrastrukturën për grumbullimin e mbeturinave që kanë kompanitë regjionale. Kompania "Pastrimi" që vepron në regjionin e Prishtinës, ka infrastrukturë më të kompletuar si nga sasia e kamionëve transportues ashtu edhe nga sasia e kontejnerëve me vëllime të ndryshme.

Ndërsa kompania "Çabrati", që vepron ne regjionin e Gjakovës dhe kompania "Pastërtia" që vepron në regjionin e Ferizajt, kanë infrastrukturë më të varfër për grumbullimin e mbeturinave.

38 Raport nga hulumtimi per qendrimet e konsumatoreve rreth sherbimeve publike per uje dhe mbeturina ne Kosove- ZRRUM, 2008

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Tabela 30: Infrastruktura për grumbullimin e mbeturinave sipas kompanive[39]

Nr.	Kompania	Regjioni	Kamion transportues (njësia/copë)	Kontejner 1.1 m³ (njësia/copë)	Kontejner 5. 0 m³ (njësia/copë)	Kontejner 7. 0 m³ (njësia/copë)
1	Ambienti	Pejë	16	1130	16	28
2	Çabrati	Gjakovë	5	146	-	22
3	Eko-Regjioni	Prizren	17	1070	12	47
4	Higjiena	Gjilan	11	1291	16	-
5	Pastërtia	Ferizaj	8	738	78	-
6	Pastrimi	Prishtinë	56	2400	-	135
7	Unitetit	Mitrovicë	15	890	30	117

5.3. PROJEKTET DHE INVESTIMET NË SEKTORIN E MBETURINAVE

Pas daljes nga lufta, gjendja për administrimin e mbeturinave në Kosovë ka qenë shumë e keqe. Duke parë situatën e tillë në infrastrukturën për administrimin e mbeturinave është ndier nevoja për investime. Investitori më i madh ka qenë AER, i cili në infrastrukturën për administrimin e mbeturinave ka investuar më se 20.000.000 euro. Gjate viteve 2007, 2008 dhe 2009 investimet janë orientuar në rehabilitimin e disa deponive dhe mbylljen e plotë të deponive të vjetra të mbeturinave komunale dhe atyre industriale. Në kuadër të Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2010, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjatë vitit 2007 ka investuar në rehabilitimin e tri deponive të mbeturinave komunale në: Kaçanik, Prizren dhe Gjakovë, ndërsa gjatë vitit 2008 janë rehabilituar deponitë në: Lipjan, Prizren dhe Gjilan. Gjatë vitit (2009) Komisioni Evropian në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor planifikon t'i rehabilitoj dhe mbyll tetë deponi të vjetra të mbeturinave komunale. Të dhëna për projektet e realizuara dhe ato të planifikuara për rehabilitimin e deponive të vjetra janë prezantuar në tabelat 31 dhe 32. Investime nga MMPH-ja për këtë vit janë planifikuar edhe në implementimin e projekteve për ndërtimin e shtatë qendrave për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore, si dhe në implementimin e projektit për mbeturina të rrezikshme, në ndërtimin e magazinave për ruajtje të përkohshme të mbeturinave të rrezikshme.

39 Kompanite regjionale te mbeturinave, 2009

Tabela 31: Projektet për rehabilitimin e deponive të vjetra të mbeturinave komunale 2004-200840

	Emri i projektit	Faza e projektit	Donatori	Viti i realizimit te projektit
1	Rehabilitimi i deponis së Suharekës	I realizuar	GTZ dhe Kuvendi Komunal-Suharekë	2004
2	Rehabilitimi i deponis së Prizrenit	I realizuar	MMPH	2007
3	Rehabilitimi i deponis së Gjakovës	I realizuar	MMPH	2007
4	Rehabilitimi i deponis së Kaçanikut	I realizuar	MMPH	2007
5	Rehabilitimi i deponis së Ferizajt	I realizuar	MMPH	2008
6	Rehabilitimi i deponis së Gjilanit	I pa përfunduar	MMPH	2008-2009
7	Rehabilitimi i deponis së Lipjanit	I realizuar	MMPH	2008

Tabela 32: Projektet e planifikuara për rehabilitimin dhe mbylljen e deponive për vitin 2009[41]

	Emri i Deponisë	Faza e projektit	Donatori
1	Rehabilitimi i deponis se Prishtinës	Përgatitje e dokumentacionit teknik për hartimin e projektit	Komisioni Evropian
2	Rehabilitimi i deponis se Podujevës	-	Komisioni Evropian
3	Rehabilitimi i deponis se Fushë Kosovës	-	Komisioni Evropian
4	Rehabilitimi i deponim se Klinës	-	Komisioni Evropian
5	Mbyllja e deponise se Ferizajt	-	Komisioni Evropian
6	Mbyllja e deponise se Gjakovës	-	Komisioni Evropian
7	Mbyllja e deponise se Kaçanikut	-	Komisioni Evropian
8	Mbyllja e Deponis se Lipjanit	-	Komisioni Evropian
9	Rehabilitimi i deponis se Rahovecit	-	MMPH
10	Rehabilitimi i deponis se Kamenicës	-	MMPH
11	Rehabilitimi i deponis se Vitisë	-	MMPH

Deponit sanitare në Kosovë janë ndërtuar kryesisht nga donacionet e AER-it, COOPI-t, DANIDA-s dhe nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Të dhëna më të detajuara për këto investime janë prezantuar në tabelën 33.

40 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 2009
41 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 2009

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Tabela 33: Investimet ne ndërtimin e deponive sanitare në Kosovë[42]

Deponitë Sanitare	Tipi i Deponisë	Donator	Kostoja e ndërtimit
Prishtinë	Regjionale	AER	3.6 mil. €
Gjilan	Regjionale	AER	2.6 mil. €
Prizren	Regjionale	AER	2.6 mil. €
Podujevë	Komunale	AER	1.2 mil. €
Mitrovicë	Regjionale	DANIDA	---
Pejë	Regjionale	COOP	---
Sharr	Komunale	AER	---
Ferizaj	Stacion transferi	AER	900.000€
Zveçan	Komunale	AER	---

42 Kompania per Menaxhimin e Deponive te Kosoves (KMDK), 2009

6. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

6.1. Konkluzionet

- Raporti identifikon se sistemi për administrimin e mbeturinave nuk është efikas dhe ka ngecje në shumë çështje;
- Mbeturinat komunale mblidhen dhe grumbullohen në shkallë vendi nga vendbanimet e Kosovës ne masën deri në 50 %;
- Gjendja në deponitë e Kosovës nuk është e mirë;
- Ka numër të madhe të deponive të egra;
- Ka mungesë të sistemit të monitorimit të gjendjes së mbeturinave;
- Mungesë e mekanizmave efikas për ndarjen, dhe seleksionimin e mbeturinave;
- Mungesë e projekteve për riciklimin e mbeturinave;
- Inkasim i ulët për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave;
- Nuk ka bazë të të dhënave për ndotjen e ujit, ajrit, dheut nga mbeturinat, vajrat dhe mbeturinat tjera industriale etj;
- Bashkëpunim jo i mjaftueshëm në mes të institucioneve;
- Nevojë për investime në sektorin e mbeturinave;
- Përshtatshmëri e pjesshme e ligjeve nacionale me direktivat e BE-së;

6.1. Rekomandimet

- Hartimi i planit strategjik për menaxhimin e mbeturinave;
- Fuqizimi i institucioneve menaxhuese të mbeturinave;
- Definimi i kompetencave dhe përgjegjësive;
- Implementimi dhe kompletimi i bazës ligjore për menaxhimin e mbeturinave;
- Promovimi i riciklimit të mbeturinave;
- Vetëdijesimi i popullatës lidhur me hedhjen e mbeturinave në vende adekuate dhe për kryerjen e obligimeve ndaj kompanive shërbyese;
- Forcimi i institucioneve lokale lidhur me menaxhimin e mbeturinave;
- Ndalimi i hedhjes së mbeturinave në deponi ilegale dhe në fushë hedhurina;
- Hartimi i programeve për zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Përforcimi i ndërmarrjeve menaxhuese të deponive;
- Hartografimi i të dhënave për administrimin e mbeturinave.

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

7. Referencat

1. Anketa e mbeturinave komunale- *Enti i Statistikave i Kosovës, 2008*
2. Gjendja e deponive të mbeturinave të pakontrolluara të egra, në Kosovë- *KLMC, 2008*
3. Mbeturinat, Paketimi dhe Mjedisi-*REC, 2002*
4. Studim mbi metodën e krahasimit të deponive-*IPA, 2007*
5. Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2010, *MMPH/REC, 2006*
6. Raporti i Monitorimit të Progresit, *REC, 2008.*
7. Raporti i gjendjes së mjedisit 2006/2007- *AKMM 2008*
8. Gjendja e mbeturinave në Kosovë 2003/2004- *MMPH, 2005*
9. Strategjia e Kosovës për Mjedis, *MMPH 2003*
10. Trajtimi i mbeturinave - Zvogëlim i rrezikut për shëndetin dhe mjedisin-*Ilir Morina, Rec Buletin 2005*
11. Raporti vjetor i përformancës së kompanive publike të ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë për vitin 2007- *ZRRUM, 2008*
12. Raport nga hulumtimi për qëndrimet e konsumatorëve rreth shërbimeve publike për ujë dhe mbeturina në Kosovë- *ZRRUM, 2008*
13. Urdhëresa e tarifave të shërbimit- *ZRRUM, 2007*
14. Ligji për mbeturina (Ligji nr. 02/L-30)
15. Ligji i Mjedisit

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

GJENDJA E MBETURINAVE NË KOSOVË 2008 / Raport

Botues:
Ministria e Mjedisit dhe Planifkimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

Këshilli Redaktues

MSc.Tafë Veselaj- AKMM
MSc.Afrim Berisha- AKMM
MSc.Mimoza Hyseni- AKMM
Ibrahim Balaj- MMPH
Bajram Kafexholli-AKMM

Kontribues tjerë:

Riza Hajdari-AKMM
Enver Tahiri-MMPH
Sabit Restelica- AKMM
Ajet Mahmuti- AKMM
Tone Gashi-AKMM
Mr.sc. Florije Tahiri- MMPH
Lindita Xhema- MMPH
Mr.sc. Sami Behrami-AKMM
Perparim Gashi- AKMM
Ardiana Pllana- AKMM

Lektor:
Tone Buzhala-Gashi

Dizajni:
Design house

Ballina dhe faqja e fundit:
Ylber Sherifi

U shtyp në shtypshkronjën:
Design house
® Ndalohet shumëzimi dhe ribotimi i paautorizuar

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

Katalogimi në botim- (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Raporti "Gjendja e mbeturinave në Kosovë-2008" shpërndahet falas. Kopjet mund të sigurohen në Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, ose mundë të shkarkohet në ueb faqen www.ks-gov.net/akmm

Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit Adresa:
Rr. "Bill Clinton" Nr. 18 Prishtinë
Tel. +381 38/ 227- 026; +381 38/227-027;
Tel/Fax. +381 38 211 685
Email: kepa@ks-gov.net

(Footnotes)

1 Po aty.
2 Numri i banoreve sipas të dhënave nga OSBE 2004
3 Llogaritja e numrit te popullsisë është kalkuluar nga Enti i Statistikave të Kosovës

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

© Agjencia e Kosoves per Mbrojtjen e Mjedisit

